

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

SKELETKURIKULI
PËR KUALIFIKIMIN PROFESIONAL

TEKNOLOGJI BUJQËSORE

Niveli IV i KSHK¹, referuar nivelit të IV të KEK²

(2-vjeçar)

Kodi: H10-IV-25

Miratoi:

MINISTRI

1.Korniza Shqiptare e Kualifikimit

2.Korniza Europiane e Kualifikimit

Tiranë, 2025

Përmbajtja

- I. Qëllimet e arsimit profesional në kualifikimin profesional “Teknologji bujqësore” Niveli IV i KSHK.**
- II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin “Teknologji bujqësore” Niveli IV i KSHK.**
 1. Kërkesat e pranimi të nxënësve në arsimin profesional, në kualifikimin profesional “Teknologji bujqësore” Niveli IV i KSHK.
 2. Kompetencat e përgjithshme kryesore të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Teknologji bujqësore” Niveli IV i KSHK.
 3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Teknologji bujqësore”, Niveli IV i KSHK.
 4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Teknologji bujqësore”, Niveli IV i KSHK.
- III. Plani mësimor për arsimin profesional të kualifikimit profesional “Teknologji bujqësore”, Niveli IV i KSHK**
- IV. Udhëzime për planin mësimor.**
- V. Udhëzime për procesin mësimor.**
- VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**
- VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të kualifikimit profesional në “Teknologji bujqësore” Niveli IV i KSHK.**
- VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.**
- IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.**
- X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.**
- XI. Programi orientues i kualifikimit profesional “Teknologji bujqësore” Niveli IV i KSHK.**

I. Qëllimet e arsimit profesional në kualifikimin profesional “Teknologji bujqësore”, Niveli IV i KSHK për kualifikimin profesional “Bujqësi”,

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në kualifikimin profesional “Teknologji bujqësore”, Niveli IV i KSHK, në drejtimin “Bujqësi, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar apo vetëpunësuar në veprimtari profesionale që lidhen me përdorimin dhe mirëmbajtjen e makinave, pajisjeve dhe sistemeve bujqësore”*. Zhvillimi të nxënësit i ndjenjës së vetëbesimit, kultivimi i vullnetit të lirë në marrjen e vendimeve, nxitja e gadishmërisë për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe për t’u zhvilluar individualisht në drejtimet emocionale, intelektuale dhe profesionale janë sfida të rëndësishme për arritjen e këtij qëllimi. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale i’u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurisë në punë dhe të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset bashkëkohore e të perspektivës në fushën e ekonomisë bujqësore dhe që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse si dhe vlerat e tyre morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

II. Kualifikimi profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin “Teknologji bujqësore”, Niveli IV i KSHK, në drejtimin “Bujqësi”.

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në kualifikimin profesional “Teknologji bujqësore” Niveli IV i KSHK.

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në profilin “Teknologji bujqësore” Niveli IV i KSHK, për kualifikimin profesional “Bujqësi” kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë e të rejtat që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në kualifikimin profesional “Bujqësi”, niveli II të KSHK;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional;
- kanë aftësi të kufizuara, për të cilët shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë MEKI përgatit udhëzime të veçanta për pranimin në këto shkolla.

2. Kompetencat e përgjithshme kryesore të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Teknologji bujqësore” Niveli IV i KSHK.

Në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Teknologji bujqësore”, Niveli IV i KSHK, nxënësi do të ketë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tyre dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.

- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efçente.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt, procesin e të nxënës të tyre dhe të shfaqin gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojnë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojnë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në profilin “Teknologji bujqësore”, Niveli IV i KSHK.

Me përfundimin me sukses të kualifikimit profesional “Teknologji bujqësore” Niveli IV i KSHK, nxënësi do të jetë i aftë të ushtrojë kompetencat profesionale si më poshtë:

- Të organizojë vendin dhe mjetet e punës
- Të përdorë veglat, pajisjet dhe instrumentat e punës
- Të përdorë mjetet motorike si buirme energjie për vënien në punë të makinave bujqësore
- Të përdorë makinat dhe pajisjet për punimin e tokës
- Të përdorë makinat dhe pajisjet për mbjelljen e bimëve
- Të përdorë makinat dhe pajisjet për shërbimin e bimëve
- Të përdorë makinat dhe pajisjet për korjen, vjeljen dhe mbledhjen e prodhimit
- Të përdorë makinat dhe pajisjet për përpunimin, magazinimin dhe ruajtjen e prodhimit
- Të përdorë makinat dhe pajisjet për mbledhjen e prodhimeve bujqësore
- Të përdorë makinat dhe pajisjet për përpunimin e prodhimeve bujqësore
- Të përdorë makinat dhe pajisjet për proceset e punës në blegtori
- Të përdorë rimorkiot për transport në bujqësi
- Të kryejë regjistrimet dhe përshtatjet e makinave dhe pajisjeve për lloje dhe regjime të ndryshme punimesh bujqësore
- Të mirëmbajë makinat dhe pajisjet bujqësore
- Të kryejë riparime të defekteve të lehta dhe zëvendësime të pjesëve në makinat dhe pajisjet bujqësore
- Të plotësojë dokumentacionin teknik për përdorimin, mirëmbajtjen dhe riparimet e lehta të makinave dhe pajisjeve bujqësore
- Të zbatojë standardet e profesionit gjatë përdorimit të makinave dhe pajisjeve bujqësore
- Të konceptojë planin për hapjen e një biznesi të vogël për përdorimin dhe mirëmbajtjen e makinave dhe pajisjeve bujqësore
- Të kryejë llogaritje ekonomike që lidhen me veprimtarinë e përdorimit të makinave dhe pajisjeve bujqësore
- Të kryejë shitblerjen e mjeteve, pajisjeve dhe makinerive bujqësore
- Të kryejë inventarizimin e fermës
- Të kryejë trajnime profesionale dhe në karrierë
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë kryerjes së veprimtarive
- Të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përdorimit të makinave dhe

pajisjeve bujqësore

4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtijshëm në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Teknologji bujqësore” Niveli IV i KSHK.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në kualifikimin profesional “Teknologji bujqësore” Niveli IV i KSHK të kualifikimit profesional “Bujqësi”, e pajis nxënësin me Diplomën e Maturës Shtetërore Profesionale, si dhe me Certifikatën e nivelit teknik/menaxherial në fushën e përdorimit të teknologjisë bujqësore. Ky kualifikim i jep nxënësit mundësinë që t’i drejtohet tregut të punës për punësim në ferma bujqësore dhe blegtorale, për kryerjen e mekanizuar të punimeve bujqësore, në parqe të makinave bujqësore që kryejnë veprimtari në fushën e përdorimit dhe mirëmbajtjes së makinave, pajisjeve dhe sistemeve të bujqësisë, në përdorimin dhe mirëmbajtjen e makinave, pajisjeve për punime në sektorin publik të shërbimeve. Pas një përvoja pune e trajnimeve të vazhdueshme, ai mund të krijojë një sipërmarrje të vetën duke punësuar edhe individë të tjerë në kuadrin e një biznesi në fushën e përdorimit dhe mirëmbajtjes së teknologjisë bujqësore. Me përfundimin e këtij niveli, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin pas të mesëm ose në nivelin e studimeve universitare.

IV. Plani mësimor për arsimin profesional në kualifikimin profesional “Teknologji bujqësore”, Niveli IV i KSHK

Plani mësimor për profilin “Teknologji bujqësore” Niveli IV i KSHK				
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Niveli IV i KSHK	
			Orët javore/vjetore	
			Klasa 12	Klasa 13
A.		Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)	10/11 (360/ 396)	14/15 (448/ 480)
1		Gjuhë shqipe	1	1
2		Letërsi	1	1
3		Gjuhë e huaj e parë	2	2
4		Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë)	(1)	(1)
5		Matematikë	2	2
6		Fizikë	-	1
7		Biologji	-	2
8		Shkenca sociale	-	1
9		Histori	1	1
10		Gjeografi	1	-
11		Teknologji informacioni dhe komunikimi (TIK)	1	1
12		Edukim fizik, sporte, shëndet	1	2
B.		Lëndët profesionale (Gjithsej)	8 (288)	10 (320)
1	L-17-157-22	Bazat e sipërmarrjes	2	2
2	L-05-198-24	Mjedis dhe zhvillimi i qëndrueshëm		1

3	L-36-719-25	Mjetet motorike	2	-
4	L-36-720-25	Mjetet/makinat bujqësore për përgatitjen e tokës për mbjellje	2	-
5	L-36-721-25	Mjetet/makinat bujqësore për mbjelljen dhe shërbimet kulturore	2	-
6	L-36-722-25	Mjetet/makinat për vjeljen, transportin dhe magazinimin e prodhimeve bujqësore	-	3
7	L-17-723-25	Planifikimi, organizimi dhe drejtimi në teknologjinë bujqësore	-	2
8	L-36-724-25	Mjetet e mekanizuara për shërbimet bazë blegtorale	-	2
C.		Module të detyruara të praktikës profesionale (Gjithsej)	9 (324)	6 (192)
1	M-05-2128-25	Rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit në teknologjinë bujqësore	30	-
2	M-36-1608-20	Përdorimi i traktorit me rrota	75	-
3	M-36-1609-25	Përdorimi i makinave për punimin e tokës	78	-
4	M-36-1610-25	Përdorimi i makinave mbjellëse	69	-
5	M-36-2129-25	Përdorimi i makinave dhe pajisjeve për shërbimin e bimëve	72	-
6	M-36-2130-25	Përdorimi i makinave dhe pajisjeve për korrjen, vjeljen dhe mbledhjen e prodhimit	-	33
7	M-36-2131-25	Përdorimi i makinave për përpunimin, magazinimin dhe ruajtjen e prodhimit.	-	33
8	M-36-1615-25	Përdorimi i makinave blegtorale	-	33
9	M-38-2132-25	Komunikimi etik dhe profesional në teknologjinë bujqësore		33
10	M-17-2133-25	Edukim karriere në teknologjinë bujqësore		30
11	M-36-2134-25	Shitblerja e mjeteve, pajisjeve dhe makinerive bujqësore	-	30
D.		Module me zgjedhje të detyruara të praktikës profesionale (Gjithsej)	3 (108)	-
1	M-36-1616-20	Përdorimi i makinave të përbëra në bujqësi	54	-
2	M-36-1617-20	Përdorimi i rimorkjos për transport	54	-
3	M-36-1618-20	Përdorimi i motokultivatorit	54	-
4	M-17-2135-25	Inventarizimi i fermës	54	-
5	M-17-2199-25	Shoqëria e nxënësve	54	-
		Gjithsej A+B+C+D	30/31 (1080/1116)	30/31 (960/992)

IV. Udhëzime për planin mësimor

Kohëzgjatja e vitit shkollor është:

Në klasën 12, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (36 javë mësimore).

Në klasën 13, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (32 javë mësimore + 4 javë provime të Maturës Shtetërore Profesionale).

Një javë mësimore ka jo më shumë se 31 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në kualifikimin profesional “Teknologji bujqësore”, Niveli IV i KSHK, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MAS).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe moduleve të praktikave profesionale duhet të për zgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënësit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin tek ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që *planifikimi i mësimdhënies* të bazohet në një proces analizë fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritetit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Gjatë tërë shkollimit dhe specializimit të tij, do të kihet parasysh se ekonomia e vendit nuk është e shprehur nga ajo ndërkombëtare dhe se për më tepër në ditët tona marrëdhëniet ndërkombëtare bëhen gjithnjë e më intensive, sidomos me rënien e kufijve ndërmjet gjithnjë e më shumë vendeve evropiane, drejt të cilave synon dhe Shqipëria.

Sidoqoftë, funksionet dhe detyrat e tij konsistojnë kryesisht në nivelin zbatues dhe, më pak, në atë vendim-marrës dhe menaxhues të nivelit të lartë, gjë që kushtëzohet nga niveli i këtij arsimit profesional.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënësit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të kualifikimit profesional “Teknologji bujqësore”, Niveli IV i KSHK.

Mësuesit duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi. Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit është fakti që *të nxënësit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm në kualifikimin profesional “Teknologji bujqësore” Niveli IV i KSHK.

Në rastin e nxënësve me aftësi të kufizuara, mësuesit duhet të përshtasin programet e lëndëve dhe përshkruesit e moduleve në përputhje me mundësitë e tyre, si dhe të krijojnë kushte për zbatimin e tyre.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 13-të, nxënësi i arsimuar në kualifikimin profesional “Teknologji bujqësore”, Niveli IV i KSHK, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:

- a) Provimeve të maturës shtetërore profesionale (sipas udhëzimeve të MAS dhe MEKI)
- b) Provimit të praktikës profesionale të integruar;

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit njohurive nga lëndët teorike, të përgjithshme dhe profesionale, si dhe të kompetencave profesionale, të nevojshme për të punuar në fushën e përdorimit dhe mirëmbajtjes së makinave dhe pajisjeve bujqësore. Në përfundim, nxënësve u jepet diploma e maturës shtetërore profesionale dhe certifikata e përgatitjes profesionale, në të cilat evidentohen notat përfundimtare të lëndëve teorike të përgjithshme dhe profesionale, të moduleve të praktikës profesionale dhe të provimeve përfundimtare.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në profilin “Teknologji bujqësore”, Niveli IV i KSHK.

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Teknologji bujqësore”, Niveli IV i KSHK, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Certifikatën e aftësimit profesional në nivelin e menaxherit në këtë profil profesional, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MEKI, këto dëshmi përmbajnë:

- a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.
- b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:
 - rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale, për çdo vit shkollor;
 - rezultatet e provimeve përfundimtare të Nivelit IV të KSHK.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

1. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-157-22). Kl. 12 – 72 orë dhe kl. 13 – 64 orë

• Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12, nxënësit duhet:

- të përshkruajnë kuptimin, rëndësinë dhe rolin e sipërmarrjes në kontekstin individual dhe shoqëror
- të përshkruajnë veçoritë e sjelljes sipërmarrëse të individëve
- të analizojnë aftësitë dhe mundësitë personale në kontekstin e nismave sipërmarrëse
- të bëjnë vlerësimin e kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive të tyre për karrierën e ardhëshme
- të zbatojnë procedurat për zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve të duhura në lidhje me to.
- të mbajnë qëndrim kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve të mundshme
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e etikës së komunikimit dhe negocimit në kontekste të ndryshme jetësore
- Të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e punës individuale dhe të punës në grup
- të analizojnë veçoritë e gadishmërisë, iniciativës dhe motivimit në kontekste të ndryshme jetësore
- Të tregojnë përgjegjësi individuale dhe shoqërore në kontekste të ndryshme jetësore
- të planifikojnë, sigurojnë dhe përdorin me efikasitet burimet e ndryshme si mjedisin, paratë, kohën etj.
- të përshkruajnë veçoritë dhe kërkesat për udhëheqjen e sipërmarrjeve të ndryshme
- të përshkruajnë veçoritë dhe impaktin e globalizimit, informacionit, mjedisit dixhital dhe mediave sociale në shoqërinë e sotme dhe të së ardhmes
- të përshkruajnë veçoritë e sipërmarrjes së biznesit dhe të sipërmarrjes sociale
- Të përshkruajnë format e ndryshme të organizimit të sipërmarrjeve dhe karakteristikat e tyre
- të analizojnë faktorët që ndikojnë në veprimtarinë e sipërmarrjeve, të tillë si tregjet, klientela, konkurrenca, kostot etj.
- të përshkruajnë mjedisin ligjor dhe fiskal të sipërmarrjeve
- të përshkruajnë marrëdhëniet e punës në një sipërmarrje
- të përshkruajnë hapat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve individuale dhe kolektive në mjedisin e punës.

• Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12 – 72 orë

Tema 1	Kuptimi, rëndësia dhe roli i sipërmarrjes	3 orë
Tema 2	Aftësitë (sjellja) sipërmarrëse	3 orë
Tema 3	Vetvlerësimi i potencialit personal	3 orë
Tema 4	Vlerësimi i kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive	3 orë
Tema 5	Zgjidhja e problemeve dhe vendimmarrja	4 orë
Tema 6	Qëndrimi kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve	3 orë
Tema 7	Etika e komunikimit dhe negocimit	3 orë
Tema 8	Puna individuale dhe puna në grup	4 orë

Tema 9	Gadishmëria, iniciativa dhe motivimi	3 orë
Tema 10	Përgjegjësia individuale dhe shoqërore	3 orë
Tema 11	Menaxhimi eficient i burimeve	3 orë
Tema 12	Aftësitë udhëheqëse në kontekstin e sipërmarrjes	3 orë
Tema 13	Globalizimi, informacioni, mjedisi dixhital dhe mediat sociale	4 orë
Tema 14	Sipërmarrja e biznesit dhe sipërmarrja sociale	3 orë
Tema 15	Format e organizimit të sipërmarrjeve	5 orë
Tema 16	Konteksti i sipërmarrjeve	6 orë
Tema 17	Mjedisi ligjor i sipërmarrjeve	4 orë
Tema 18	Marrëdhëniet e punës	4 orë
Tema 19	Zgjidhja e mosmarrëveshjeve në mjedisin e punës	4 orë
Tema 20	Vizitë studimore në një sipërmarrje të suksesshme	4 orë

• **Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 13.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.13, nxënësit duhet:

- të analizojnë veçoritë e etikës dhe komunikimit në kontekstin e veprimtarisë së bizneseve
- të bëjnë vlerësimin e mundësive dhe rreziqeve në kontekstin e konceptimit të idesë së biznesit
- të përshkruajnë rëndësinë dhe strukturën e një plani biznesi
- të zbatojnë procedurat e regjistrimit dhe përshkruajnë fazat e zhvillimit të biznesit
- të konceptojnë strukturën organizative dhe përshkrimet e punës së personelit të një biznesi
- të përshkruajnë veçoritë e planifikimit, rekrutimit, seleksionimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore të një biznesi
- të analizojnë aspektet e buxhetimit të një biznesi
- të kryejnë llogaritje ekonomike në kuadrin e kontabilitetit financiar të një biznesi
- të llogarisin kostot dhe çmimet e produkteve e shërbimeve të një biznesi
- të analizojnë aspektet e marketingut dhe teknikat e shitjeve në një biznes
- të analizojnë rolin dhe teknikat e e-sipërmarrjes në veprimtarinë e bizneseve.
- të përshkruajnë dhe simulojnë veprimet individuale me bankat, në lidhje me llogaritë, transfertat, kreditë dhe investimet.
- të analizojnë llojet e siguracioneve personale dhe veprimet që kryhen me to.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.13 - 64 orë**

Tema 1	Etika dhe komunikimi në biznes	4 orë
Tema 2	Konceptimi i idesë së biznesit, vlerësimi i mundësive dhe rreziqeve	6 orë
Tema 3	Hartimi i planit të biznesit	6 orë
Tema 4	Procedurat e regjistrimit të biznesit	6 orë
Tema 5	Struktura organizative dhe personeli i biznesit	5 orë
Tema 6	Planifikimi, rekrutimi, seleksionimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore	6 orë
Tema 7	Kostimi dhe çmimi i produkteve dhe shërbimeve	4 orë
Tema 8	Kontabiliteti financiar në kuadrin e biznesit	6 orë
Tema 9	Buxhetimi në biznes	4 orë
Tema 10	Marketingu dhe shitjet në biznes	9 orë

Tema 11	E – sipërmarrja	2 orë
Tema 12	Veprimet individuale me bankat	3 orë
Tema 13	Siguracionet personale	3 orë

2. Lënda “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm” (L-05-198-24). Kl.13 – 32 orë

• Synimet e lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, nxënësit duhet:

- të shpjegojnë kuptimin e qëndrueshmërisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm;
- të shpjegojnë objektivat për zhvillim të qëndrueshëm;
- të shpjegojnë kuptimin për aftësitë e gjelbra në një ekonomi të gjelbër;
- të shpjegojnë rëndësinë e aftësive digjitale në përballimin e sfidave globale;
- të analizojnë mjedisin dhe komponentët e tij;
- të shpjegojnë ekosistemet dhe biodiversitetin;
- të analizojnë ndryshimet klimatike dhe ndikimet e tyre;
- të shpjegojnë burimet natyrore të ripërtëritshme dhe jo të ripërtëritshme;
- të përshkruajë mënyrën e shpjegimit të të dhënave mjedisore;
- të shpjegojnë rëndësinë e menaxhimit të mbetjeve, riciklimi dhe zgjidhjet digjitale;
- të shpjegojnë kuptimi i cikleve të jetës së produktit dhe krijimi i mbetjeve;
- të përshkruajnë parimet bazë të ekonomisë qarkulluese;
- të shpjegojnë proceset dhe teknologjitë e riciklimit;
- të shpjegojnë dhe japin shembuj nga drejtimet profesionale mbi reduktimi, ripërdorimi dhe riciklimin.
- të hulumtojnë mbi platformat digjitale për programet e menaxhimit të mbetjeve
- të shpjegojnë optimizimin e proceseve të riciklimit duke përdorur teknologjinë
- të shpjegojnë avantazhet e zgjidhjeve digjitale për mirëmenaxhimin e mbetjeve
- të shpjegojnë rëndësinë e ruajtja, menaxhimi dhe monitorimi digjital të burimeve ujore në drejtimet profesionale përkatëse
- të përshkruajë praktikatat e qëndrueshme të menaxhimit të ujit në fushën profesionale përkatëse.
- të dallojë dhe përdorë sistemet digjitale të monitorimit të përdorimit dhe cilësisë së ujit
- të shpjegojnë teknologjitë inteligjente për menaxhimin e qëndrueshëm të ujit
- të përshkruajë transporti i qëndrueshëm, lëvizshmëria e zgjuar dhe zgjidhjet digjitale në drejtimet profesionale përkatëse
- të dallojë opsionet alternative të transportit (p.sh., transporti publik, biçikleta, ecje) si dhe përdorimin e mjeteve elektrike në veprimtari të ndryshme profesionale;
- të dallojë platformat digjitale për transport të qëndrueshëm si dhe Integrimin e teknologjive inovative në sistemet e transportit publik
- të shpjegojnë kuptimin dhe rëndësinë mbi konsumin e qëndrueshëm, tregun digjital dhe marketingun digjital
- të dallojë praktikatat etike të konsumit, zgjedhjet e konsumatorëve dhe ndikimet e tyre mjedisore

- të shpjegojë praktika dhe platforma të qëndrueshme të tregtisë elektronike si dhe kuptimin për marketingun digjital për promovimin e produkteve eko-miqësore
- të përshkruajnë modele të qëndrueshme biznesi bazuar në praktika të ekonomisë së gjelbër dhe digjitale
- të shpjegojë politikat për zhvillim të qëndrueshëm në fusha të ndryshme profesionale
- të shpjegojnë konsideratat etike në qeverisjen digjitale për qëndrueshmëri

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”**

Tema 1	Zhvillimi i qëndrueshëm	3 orë
Tema 2	Bazat e shkencës mjedisore	3 orë
Tema 3	Menaxhimit të mbetjeve, riciklimi dhe zgjidhjet digjitale	6 orë
Tema 4	Ruajtja, menaxhimi dhe monitorimi digjital i burimeve ujore	4 orë
Tema 5	Transporti i qëndrueshëm, lëvizshmëria e zgjuar dhe zgjidhjet digjitale	4 orë
Tema 6	Konsumi i qëndrueshëm, tregu digjital dhe marketingu digjital	4 orë
Tema 7	Sipërmarrja e gjelbër, inovacioni dhe modelet digjitale të biznesit	4 orë
Tema 8	Politika dhe qeverisja për zhvillim të qëndrueshëm	4 orë

3. Lënda “Mjetet motorike” (L-36-719-25), Kl. 12 - 72 orë

• **Synimet e lëndës “Mjetet motorike”, kl. 12**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Mjetet motorike”, klasa 12, nxënësit duhet:

- të argumentojnë rëndësinë e përdorimit të mjeteve motorike që përdoren në bujqësi.
- të listojnë llojet e mjeteve motorike që përdoren në fushën e bujqësisë;
- të listojnë llojet e karburanteve dhe lubrifikantëve që përdoren në mjetet motorike;
- të shpjegojnë ndërtimin, funksionimin dhe përdorimin e motorit me djegie të brendshme;
- të shpjegojnë ndërtimin, funksionimin dhe përdorimin e traktorit bujqësor;
- të përshkruajnë ndërtimin, funksionimin dhe përdorimin e motokultivatorit;
- të klasifikojnë traktorët bujqësorë sipas sistemit të lëvizjes, fuqisë dhe përdorimit;
- të listojnë pajisjet e lidhjes së mjetit motorik me makinat bujqësore;
- të shpjegojnë ndërtimin, funksionimin dhe përdorimin e pajisjeve lidhëse të mjetit motorik me makinat/pajisjet e punës në bujqësi;
- të shpjegojnë rëndësinë e kontrollit paraprakë të mjeteve motorike;
- të shpjegojnë domosdoshmërinë e zbatimit të manualit të përdorimit të mjeteve motorike;
- të përshkruajnë mënyrat e sigurimit të mjetit motorik në shërbimet teknike ditore;
- të përshkruajnë shërbimet teknike ditore të nevojshme të mjetit motorik;
- të listojnë defektet e mundshme të mjeteve motorike;
- të përshkruajnë riparimet e thjeshta në mjetet motorike;
- të përshkruajnë shërbimet për mirëmbajtjen e mjeteve motorike;
- të përshkruajnë e rregullat e qarkullimit rrugor;

▪ **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Mjetet motorike” kl. 12 - 72 orë**

Tema 1	Rëndësia, përparësitë dhe klasifikimi i mjeteve motorike që përdoren në bujqësi.	2 orë
Tema 2	Motorët me djegie të brendshme (MDB). Klasifikimi, parimi dhe ciklet e punës së motorëve të tipeve të ndryshme.	4 orë
Tema 3	Parametrat teknikë të MDB	2 orë
Tema 4	Karburantët dhe lubrifikantët.	2 orë
Tema 5	Mekanizmat e MDB. Mekanizmi bjellë-manivelë dhe mekanizmi i shpërndarjes së gazeve.	4 orë
Tema 6	Sistemet e MDB. Sistemi i ushqimit dhe nxjerrjes së gazeve, sistemi i vajosjes, sistemi i ftohjes, sistemi i ndezjes dhe sistemi i lëshimit.	9 orë
Tema 7	Traktorët bujqësorë. Klasifikimi, karakteristikat, mekanizmat dhe sistemet kryesore	4 orë
Tema 8	Friksioni, kutia e ndërrimit të shpejtësisë, transmisioni kardanik, transmisioni qëndror, diferenciali dhe simjakset	4 orë
Tema 9	Sistemi i drejtimit të traktorëve. Tipet, ndërtimi dhe funksionimi.	9 orë
Tema 10	Sistemi frenimit të traktorëve. Tipet, ndërtimi dhe funksionimi.	4 orë
Tema 11	Sistemi lëvizës i traktorëve. Tipet, ndërtimi dhe funksionimi.	4 orë
Tema 12	Pajisjet e punës së traktorëve.	3 orë
Tema 13	Parametrat teknikë të traktorëve	6 orë
Tema 14	Përdorimi i traktorëve me rrota dhe rregullat e qarkullimit.	3 orë
Tema 15	Parregullsitë kryesore të traktorët dhe shkaqet e tyre	3 orë
Tema 16	Mirëmbajtja e traktorëve	3 orë
Tema 17	Motokultivatorët, ndërtimi, funksionimi dhe përdorimi	2 orë
Tema 18	Motorët elektrikë, përdorimi i tyre në bujqësi	4 orë

4. Lënda “Mjetet/makinat bujqësore për përgatitjen e tokës për mbjellje” (L-36-720-25), Kl. 12 –72 orë

• Synimet e lëndës ” Mjetet / makinat bujqësore për përgatitjen e tokës për mbjellje”, kl. 12

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Mjetet/makinat bujqësore për përgatitjen e tokës për mbjellje”, klasa 12, nxënësit duhet:

- të shpjegojnë proceset teknologjike të përgatitjes së tokës për mbjellje (sistemimi i tokave në fushë dhe tokat e pjerrëta, nivelimi sipërfaqësor i ngastrës, sistemet e punimit të tokës etj.);
- të përshkruajnë mënyrat e përgatitjes së tokës për mbjellje sipas kartave teknologjike të kulturave bujqësore;
- të shpjegojnë konceptet, faktorët dhe nevojën e kullimit dhe ujitjes;
- të përshkruajnë format dhe mënyrat e kullimit dhe ujitjes;
- të interpretojnë normën agronomike të ujitjes;
- të vlerësojnë treguesit më të rëndësishëm, të cilat përcaktojnë cilësinë e ujit për ujitje;
- të argumentojnë domosdoshmërinë e mbikëqyrjes së cilësisë dhe mënyrave të ujitjes;
- të listojnë mjetet/makinat për përgatitjen e tokës për mbjellje sipas kartave teknologjike;
- të përshkruajnë ndërtimin, funksionimin dhe përdorimin e mjeteve/makinave për përgatitjen e tokës për mbjellje;
- të argumentojnë rëndësinë e kontrollit paraprak të mjeteve/makinave për përgatitjen e tokës për mbjellje;
- të përshkruajnë mënyrat e lidhjes së mjetit motorik me makinën/mjetin e punës për përgatitjen e tokës për mbjellje;

- të përshkruajnë defektet e mundshme në mjetet/makinat për përgatitjen e tokës për mbjellje;
- të përshkruajnë shërbimet bazë ditore në mjetet/makinat për përgatitjen e tokës për mbjellje;
- të shpjegojnë domosdoshmërinë e zbatimit të manualit të përdorimit të mjeteve/makinave për përgatitjen e tokës për mbjellje;
- të shpjegojnë procedurat e regjistrimit të mjeteve/makinave për përgatitjen e tokës për mbjellje dhe korrigjimeve të nevojshme sipas rastit;
- të shpjegojnë metodat fushore të vlerësimit të cilësisë të përgatitjes së tokës për mbjellje;
- të argumentojnë domosdoshmërinë e mbikëqyrjes së përgatitjes së tokës për mbjellje;

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Mjetet/makinat bujqësore për përgatitjen e tokës për mbjellje” kl. 12 – 72 orë**

Tema 1	Rëndësia dhe prespektiva e përdorimit të teknologjisë në bujqësi	2 orë
Tema 2	Klasifikimi dhe përdorimet e makinave dhe pajisjeve bujqësore	4 orë
Tema 3	Materialet që përdoren në ndërtimin e makinave bujqësore	4 orë
Tema 4	Makinat, impiantet dhe pajisjet për përmirësimin ujqor të tokës	6 orë
Tema 5	Mjetet dhe makinat bujqësore për sistemimin, nivelimin sipërfaqësor të tokës.	6 orë
Tema 6	Zbatimi i manualit të përdorimit të mjeteve/makinave për përgatitjen e tokës për mbjellje	3 orë
Tema 7	Ngarkesat që veprojnë në detalet e makinave bujqësore	3 orë
Tema 8	Defektet kryesore të makinave bujqësore dhe riparimi i tyre	4 orë
Tema 9	Shërbimet në mjetet/makinat për përgatitjen e tokës për mbjellje	5 orë
Tema 10	Regjistrimi i mjeteve/makinave për përgatitjen e tokës për mbjellje	5 orë
Tema 11	Mjetet dhe makinat plehëruese të tokës	10 orë
Tema 12	Mjetet dhe makinat e punimit bazë të tokës	10 orë
Tema 13	Mjetet dhe makinat e punimit plotësues të tokës	10 orë

5. Lënda “Mjetet / makinat bujqësore për mbjellje dhe shërbimet kulturore”, (L-36-721-25), Kl. 12 –72 orë

- **Synimet e lëndës ” Mjetet/makinat bujqësore për mbjellje dhe shërbimet kulturore”, kl. 12**
Në përfundim të trajtimit të lëndës “Mjetet/makinat bujqësore për mbjellje dhe shërbimet kulturore”, klasa 12, nxënësit duhet:
 - të shpjegojnë procesin e mbjelljes së farave, fidanëve, bul, rizomë me mjete/makina bujqësore;
 - të përshkruajnë teknikat dhe mënyrat e mbjelljes së farave, fidanëve, bul, rizomë sipas kartës teknologjike;
 - të interpretojnë normat e farës sipas kartës teknologjike;
 - të argumentojnë afatet e mbjelljes së farave, fidanëve, bulbave, rizomave sipas kartës teknologjike;
 - të listojnë llojet e plehëruesve bimorë, karakteristikat fizike, mënyrat dhe koha e përdorimit të tyre;
 - të listojnë llojet e sëmundjet dhe dëmtuesit kryesore të kulturave bujqësore;
 - të listojnë llojet e pesticideve, karakteristikat fizike, mënyrat dhe koha e përdorimit, karencën e tyre, efektet negative në shëndet dhe mjedis;
 - të argumentojnë specifikat e mjeteve/makinave për trajtimin fitosanitar të farave, fidanëve, bulbave, rizomave;

- të listojnë mjetet makinat bujqësore për mbjelljen dhe shërbimet kulturore (plehërim, trajtim fitosanitar, ujitje etj.);
- të shpjegojnë ndërtimin, funksionimin dhe përdorimin e mjete/makinave për mbjellje dhe shërbime kulturore;
- të argumentojnë rëndësinë e kontrollit paraprak të makinave për mbjellje dhe shërbime kulturore;
- të përshkruajnë mënyrat e lidhjes së mjeteve/makinave për mbjellje dhe shërbime kulturore me mjetin motorik;
- të listojnë defektet e mundshme të mjeteve/makinave për mbjellje dhe shërbime kulturore;
- të përshkruajnë shërbimet bazë të mjeteve/makinave për mbjellje dhe shërbime kulturore;
- të shpjegojnë domosdoshmërinë e zbatimit të manualit të përdorimit të mjeteve/makinave për mbjellje dhe shërbime kulturore;
- të shpjegojnë mënyrat e regjistrimit të mjeteve/makinave për mbjellje dhe shërbime kulturore dhe korrigjimeve e nevojshme sipas rastit;
- të shpjegojnë metodat e kontrollit të cilësisë së mbjelljes dhe shërbimeve kulturore;
- të argumentojnë domosdoshmërinë e mbikëqyrjes së cilësisë së mbjelljes dhe shërbimeve kulturore;

▪ **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Mjetet/makinat bujqësore për mbjellje dhe shërbimet kulturore” kl. 12- 72 orë**

Tema 1	Rëndësia e mekanizimit të procesit mbjelljes	3 orë
Tema 2	Teknikat dhe mënyrat e mbjelljes së farave, fidanëve, bul, rizomë	3 orë
Tema 3	Normat dhe afatet e mbjelljes së farave sipas kartës teknologjike	3 orë
Tema 4	Mjetet dhe makinat bujqësore për mbjellje e të lashtave	8 orë
Tema 5	Mjetet dhe makinat bujqësore për mbjellje e të vonave	8 orë
Tema 6	Mjetet dhe makinat bujqësore për mbjelljen e fidanëve	8 orë
Tema 7	Mjetet dhe makinat bujqësore për mbjelljen frutërrënjoreve	6 orë
Tema 8	Mjetet dhe makinat bujqësore për mbjelljen e dufrutoreve	5 orë
Tema 9	Mjetet dhe makinat bujqësore për mbjelljen e farave të imta	3 orë
Tema 10	Makina për pluhurizimin dhe shkrifërimin e tokës	3 orë
Tema 11	Mjetet dhe makinat bujqësore për ujitjen dhe plehërimin e bimëve	8 orë
Tema 12	Mjetet dhe makinat bujqësore për trajtimin fitosanitar të bimëve	10 orë
Tema 13	Defektet dhe shërbimet bazë të mjeteve/makinave për mbjellje dhe shërbime kulturore	4 orë

6. Lënda “Mjetet / makinat bujqësore për vjeljen, transportin dhe magazinimin e prodhimeve bujqësore.”, (L-36-722-25), kl. 13- 96 orë

• **Synimet e lëndës: “Mjetet / makinat për vjeljen, transportin dhe magazinimin e prodhimeve bujqësore.”, kl. 13- 96 orë**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Mjetet/makinat për vjeljen, transportin dhe magazinimin e prodhimeve bujqësore.”, klasa 13, nxënësit duhet:

- të shpjegojnë procesin e korrjes, vjeljes, shkuljes së prodhimeve bujqësore;
- të përshkruajnë teknikat e korrjes, vjeljes, shkuljes së prodhimeve bujqësore;
- të argumentojnë kohën e korrjes, vjeljes, shkuljes së prodhimeve bujqësore;
- të dallojnë specifikat e mjeteve/makinerive/pajisjeve për korrjen, vjeljen, shkuljen e prodhimeve bujqësore;
- të listojnë mjetet/makineritë/pajisjet për korrjen, vjeljen, shkuljen e prodhimeve bujqësore;

- të përshkruajnë ndërtimin, funksionimin, përdorimin e mjeteve/makinerive për korrjen, vjeljen, shkuljen e prodhimeve bujqësore;
- të argumentojnë rëndësinë e kontrollit paraprak të mjeteve/makinerive/pajisjeve për korrjen, vjeljen, shkuljen e prodhimeve bujqësore;
- të përshkruajnë mënyrat e lidhjes së mjeteve/makinerive/pajisjeve për korrje, vjeljen, shkuljen e prodhimeve bujqësore me mjetin motorik;
- të listojnë defektet e mundshme të mjeteve/makinerive/pajisjeve për korrje, vjelje, shkulje të prodhimeve bujqësore;
- të listojnë shërbimet bazë të mjeteve/makinerive/pajisjeve për korrje, vjelje, shkulje të prodhimeve bujqësore;
- të argumentojnë domosdoshmërinë e zbatimit të manualeve të përdorimit të mjeteve/makinerive/pajisjeve për korrje, vjelje, shkulje të prodhimeve bujqësore;
- të shpjegojnë mënyrat e regjistrimit të mjeteve/makinerive/pajisjeve për korrje, vjelje, shkulje të prodhimeve bujqësore dhe korrigjimeve të nevojshme sipas rastit;
- të shpjegojnë metodat e kontrollit të cilësisë së punimeve sipas mjeteve/makinerive/pajisjeve për korrje, vjelje, shkulje të prodhimeve bujqësore;
- të përshkruajnë ndërtimin, funksionimin dhe përdorimin e autokombajnave.
- të shpjegojnë ndërtimin, funksionin dhe përdorimin e makinerive, pajisjeve dhe platformave digjitale në bujqësi;
- të argumentojnë rëndësinë e transportit, magazinimit, manipulimit dhe ruajtjes së prodhimeve bujqësore;
- të përshkruajnë teknikat dhe mënyrat e transportit të prodhimeve bujqësore;
- të përshkruajnë mënyrat e magazinimit, manipulimit dhe ruajtjes së prodhimeve bujqësore;
- të argumentojnë kohën optimale për transportin, magazinimin, manipulimin dhe ruajtjen e prodhimeve bujqësore;
- të argumentojnë rëndësinë e faktorëve klimatike gjatë proceseve të transportit, magazinimit, manipulimit dhe ruajtjes së prodhimeve bujqësore;
- të listojnë mjetet/makineritë/pajisjet për transportin, magazinimin, manipulimin dhe ruajtjen e prodhimeve bujqësore;
- të listojnë specifikat e mjeteve/makinerive/pajisjeve për transportin, magazinimin, manipulimin dhe ruajtjes së prodhimeve bujqësore;
- të përshkruajnë ndërtimin, funksionimin e përdorimin e mjeteve/makinerive/pajisjeve për transportin, magazinimin, manipulimin dhe ruajtjen e prodhimeve bujqësore;
- të argumentojnë rëndësinë e kontrollit paraprak të mjeteve/makinerive/pajisjeve për transportin, magazinimin, manipulimin dhe ruajtjen e prodhimeve bujqësore;
- të përshkruajnë mënyrat e lidhjes së mjeteve/makinerive/pajisjeve për transportin, magazinimin, manipulimin dhe ruajtjen e prodhimeve bujqësore me mjetin motorik;
- të përshkruajnë burimet e energjisë për mjetet/makineritë/pajisjet për transportin, magazinimin, manipulimin dhe ruajtjen e prodhimeve bujqësore sipas manualit të përdorimit;
- të listojnë defektet e mundshme të mjeteve/makinerive/pajisjeve për transportin, magazinimin, manipulimin dhe ruajtjes së prodhimeve bujqësore;
- të përshkruajnë shërbimet bazë të mjeteve/makinerive/pajisjeve për transportin, magazinimin, manipulimin dhe ruajtjes së prodhimeve bujqësore;
- të argumentojnë domosdoshmërinë e zbatimit të manualeve të përdorimit të mjeteve/makinerive/pajisjeve për transportin, magazinimin, manipulimin dhe ruajtjen e prodhimeve bujqësore;
- të shpjegojnë mënyrat e regjistrimit të mjeteve/makinerive/pajisjeve për transportin, magazinimin, manipulimin dhe ruajtjen e prodhimeve bujqësore dhe korrigjimeve e nevojshme sipas rastit;

- të shpjegojnë metodat e kontrollit të cilësisë së punës të mjeteve/makinerive/pajisjeve për transportin, magazinimin, manipulimin dhe ruajtjen e prodhimeve bujqësore.
- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Mjetet/makinat për vjeljen, transportin dhe magazinimin e prodhimeve bujqësore.” kl. 13-96 orë**

Tema 1	Procesi i korrjes, vjeljes, shkuljes së prodhimeve bujqësore	2 orë
Tema 2	Koha dhe teknikat e korrjes, vjeljes, shkuljes së prodhimeve bujqësore	4 orë
Tema 3	Mjetet dhe makineritë e korrjes, vjeljes dhe shkuljes së prodhimeve bujqësore	4 orë
Tema 4	Mënyrat e lidhjes së mjeteve/makinerive dhe pajisjeve për korrje, vjeljen, shkuljen e prodhimeve bujqësore me mjetin motorik;	4 orë
Tema 5	Makinat korrëse	5 orë
Tema 6	Makinat shirëse	5 orë
Tema 7	Ndërtimi, funksionimi dhe përdorimi i autokombajnave	8 orë
Tema 8	Defektet e mundshme të mjeteve/makinerive dhe pajisjeve për korrje, vjelje, shkulje të prodhimeve bujqësore	5 orë
Tema 9	Shërbimet në mjetet/makineritë për korrjen, vjeljen, shkuljen e prodhimeve bujqësore.	4 orë
Tema 10	Përdorimi i pajisjeve dhe platformave digjitale në bujqësi.	5 orë
Tema 11	Rëndësia e transportit, magazinimit, manipulimit dhe ruajtjes së prodhimeve bujqësore.	5 orë
Tema 12	Teknikat dhe mënyrat e transportit të prodhimeve bujqësore	5 orë
Tema 13	Mjetet, pajisjet dhe makineritë për transportin e prodhimeve bujqësore	6 orë
Tema 14	Ndërtimi, funksionimi i mjetet, pajisjet dhe makineritë për transportin e prodhimeve bujqësore	6 orë
Tema 15	Defektet e mundshme të mjeteve/makinerive dhe pajisjeve për transportin, e prodhimeve bujqësore	6 orë
Tema 16	Shërbimet bazë të mjeteve/makinerive dhe pajisjeve për transportin, e prodhimeve bujqësore	4 orë
Tema 17	Mjetet, pajisjet dhe makineritë për magazinimin, manipulimin dhe ruajtjen e prodhimeve bujqësore	6 orë
Tema 18	Ndërtimi, funksionimi i mjetet, pajisjet dhe makineritë për magazinimin, manipulimin dhe ruajtjen e prodhimeve bujqësore	6 orë
Tema 19	Defektet e mundshme të mjeteve/makinerive dhe pajisjeve për magazinimin, manipulimin dhe ruajtjen e prodhimeve bujqësore	2 orë
Tema 20	Regjistrimi dhe kontrolli i cilësisë së punës të mjeteve/makinerive dhe pajisjeve bujqësore	4 orë

7. Lënda “Planifikimi, organizimi dhe drejtimi në teknologjinë bujqësore” (L-17-723-25), kl.13 – 64 orë

- **Synimet e lëndës “Planifikimi, organizimi dhe drejtimi në teknologjinë bujqësore”, kl.13**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Planifikimi, organizimi dhe drejtimi në teknologjinë bujqësore ” kl.13 nxënësi duhet:

- të përshkruajnë aspektet kryesore të drejtimit në teknologjinë bujqësore.
- të përshkruajnë karrierat e punësimeve në teknologjinë bujqësore.
- të shpjegojnë ç’është prona dhe elementët e së drejtës së pronësisë;
- të listojnë disa standarde që veprojnë në sektorin bujqësor;
- të interpretojnë parimet e përgjithshme të legjislacionit kombëtar për rregullimin e territorit në përgjithësi dhe atij për mbrojtjen e tokës në veçanti;
- të përshkruajnë rëndësinë dhe mënyrën e organizimit të punës në fermë, si një element mjaft i rëndësishëm i menaxhimit të fermës;
- të shpjegojnë format e ndryshme të organizimit të fermës dhe rolin e tyre në ekonominë e vendit;
- të listojnë faktorët që ndikojnë në organizimin e punës dhe ndikimin e tyre në suksesin e fermës;
- të analizojnë rubrikat e një plani prodhimi bujqësor;
- të identifikojnë prioritetet e proceseve të punës ditore;
- të shpjegojnë mënyrat e planifikimit të mjeteve/makinave dhe tipet përkatëse për realizimin e proceseve të punës (përgatitja e tokës, mbjellja, shërbimet kulturore, korrja/vjelja, transporti dhe magazinimi i prodhimeve bujqësore;
- të shpjegojnë mënyrat e planifikimit të kohës së përdorimit të mjeteve/makinave sipas proceseve të punës;
- të shpjegojnë mënyrat e planifikimit të burimeve (financiare, materiale dhe njerëzore);
- të shpjegojnë kriteret e përzgjedhjes së mjeteve/makinave të nevojshme për çdo proces;
- të shpjegojnë mënyrat e menaxhimit të burimeve të nevojshme (njerëzore, financiare dhe materiale) për kryerjen e proceseve të punës;
- të shpjegojnë metodat e përzgjedhjes dhe ndarjes së detyrave sipas kualifikimeve përkatëse;
- të tregojnë mënyrat e evidentimit dhe raportimeve për veprimtarinë e kryer;
- të shpjegojnë rëndësinë e përditësimit të informacionit me teknologjitë e reja bujqësore dhe platformave digjitale;
- të argumentojnë rëndësinë dhe mënyrat e bashkëpunimit me eprorin dhe specialistë të tjerë;
- të përshkruajnë format e organizimit të vendit të punës në mënyrë ergonomike;
- të listojnë llojet e dokumentacionit përkatës në funksion të organizimit të punës (urdhër pune, proces verbale të fillimit dhe mbarimit të punës etj.);
- të përshkruajnë procesin e marrjes së vendimeve, funksionet dhe fushat e drejtimit të fermës bujqësore.
- të përshkruajnë marrëdhëniet e prodhimit, llojet e produktit, marrëdhëniet e kostove dhe ligjin e fitimeve në rënie, si dhe zgjedhjen e nivelit të përdorimit të faktorëve prodhues me të gjitha llojet e alternativat.
- të përshkruajnë procedurat e planifikimit të përgjithshëm të fermës, pjesët përbërëse të buxhetit dhe buxhetin e lëvizjes së parave.
- të përshkruajnë llojet e rriskut dhe qëndrimet e fermerit ndaj tyre.
- të theksojnë përshkrimet e punës të personelit në fermat bujqësore.
- të përshkruajnë se si bëhet ndarja e detyrave dhe organizimi i vogël i punës në fermat bujqësore.
- të përshkruajnë marrëdhëniet juridike të të punësuarve në fermat bujqësore.
- të përshkruajnë kuptimin e kontratës dhe llojet e kontratave.
- të përshkruajnë kuptimin, rëndësinë dhe praktikën e marketingut dhe planifikimin e tij.
- të listojnë burimet e sigurimit të kapitalit në fermë dhe faktorët që ndikojnë në marrjen dhe dhënien e kredisë në bujqësi.
- të analizojnë investimet kapitale në bujqësi.
- të përshkruajnë format e ndryshme të administrimit të tokës: blerja e tokës, qeraja etj.

- të përshkruajë burimet e sigurimit të makinave, pajisjeve dhe sistemeve bujqësore, blerja dhe marrja me qera, si dhe mënyrën e llogaritjes së kostove të përdorimit dhe mirëmbajtjes së tyre.
 - të shpjegojnë domosdoshmërinë e rritjes së fermës në varësi të kushteve dhe burimeve financiare.
 - të dallojnë konceptet: “pasuri”, “detyrim” dhe “kapital” të ndërmarrjes bujqësore.
 - të krahasojnë konceptin e bilancit me atë të inventarit.
 - të zbërthejnë bilancin në llogari aktive dhe pasive.
 - të regjistrojnë në llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve.
 - të regjistrojnë në llogaritë përkatëse shitjet dhe blerjet e kryera.
 - të regjistrojnë në kontabilitet shlyrjen e detyrimit ndaj shtetit për t.v.sh.
 - të regjistrojnë kontabël të shpenzimeve të lindura gjatë shitjes dhe blerjes si dhe lëvizjen e ambalazheve.
 - të përshkruajnë regjistrimet kontabël në fushën e personelit dhe qarkullimin e pagesave.
 - të përshkruajnë procedurën e plotë që çon në hartimin e bilancit përfundimtar.
 - të argumentojnë domosdoshmërinë e analizës dhe vlerësimit të mbylljes vjetore.
- **Përmbajtja e përgjithshme e lëndës “Planifikimi, organizimi dhe drejtimi në teknologjinë bujqësore” kl.13 – 64 orë**

Tema 1	Aspekte kryesore të drejtimit në teknologjinë bujqësore.	2 orë
Tema 2	Karrierat e punësimeve në teknologjinë bujqësore.	2 orë
Tema 3	Parimet ekonomike të drejtimit në teknologjinë bujqësore.	3 orë
Tema 4	Teknikat e buxhetimit dhe të planifikimit bujqësor.	3 orë
Tema 5	Drejtimi i fermës dhe kushtet e riskut dhe pasigurisë.	3 orë
Tema 6	Përshkrimet e punës të personelit në teknologjinë bujqësore.	3 orë
Tema 7	Ndarja e detyrave dhe organizimi i vogël i punës në teknologjinë bujqësore	3 orë
Tema 8	Marrëdhëniet juridike të të punësuarve në teknologjinë bujqësore	2 orë
Tema 9	Prona dhe elementët e së drejtës së pronësisë	2 orë
Tema 10	Bashkëpronësia dhe shpronësimi	3 orë
Tema 11	Kontratat, veçoritë e kontratave në sektorin bujqësor	2 orë
Tema 12	Marketingu bujqësor	3 orë
Tema 13	Sigurimi i kapitalit dhe kredisë në bujqësi.	2 orë
Tema 14	Sigurimi dhe drejtimi i krahut të punës.	3 orë
Tema 15	Sigurimi dhe përdorimi i makinerive bujqësore.	5 orë
Tema 16	Detyrat e kontabilitetit, inventarizimi dhe bilanci në bujqësi	4 orë
Tema 17	Llogaritë e rezultatit dhe llogaritë e mallrave	3 orë
Tema 18	Tatimi mbi vlerën e shtuar	3 orë
Tema 19	Rregjistrimet për blerjet dhe shitjet	3 orë
Tema 20	Aktivitetet e qëndrueshme dhe rregjistrimet që lidhen me to	3 orë
Tema 21	Rregjistrimet kontabël, mbyllja vjetore dhe analiza e bilancit	7 orë

8. Lënda “Mjetet e mekanizuara për shërbimet bazë blegtorale” (L-36-724-25), Kl. 13- 64 orë

- **Synimet e lëndës “Mjetet e mekanizuara për shërbimet bazë blegtorale”, kl.13**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Mjetet e mekanizuara për shërbimet bazë blegtorale” kl.13 nxënësi duhet:

- të listojnë mjetet, pajisjet dhe makineritë për shërbimet bazë blegtorale;

- të shpjegojnë ndërtimin, funksionimin dhe përdorimin e mjeteve, pajisjeve dhe makinerive për shërbimet bazë blegtorale;
- të përshkruajnë mënyrat e vënies në punë të pajisjeve, mjeteve dhe makinerive për shërbimet bazë blegtorale;
- të argumentojnë rëndësinë e manualeve të përdorimit të mjeteve, pajisjeve dhe makinerive për shërbimet bazë blegtorale;
- të listojnë defektet e mundshme të mjeteve, pajisjeve dhe makinerive për shërbimet bazë blegtorale;
- të përshkruajnë mënyrën e riparimeve të thjeshta të mjeteve, pajisjeve dhe makineritë për shërbimet bazë blegtorale.
- të përshkruajnë llojet, ndërtimin, funksionimin dhe përdorimin e makinave dhe impianteve të blegtorisë.
- të përshkruajnë llojet, ndërtimin, funksionimin dhe përdorimin e makinave dhe pajisjeve për transportin prodhimit blegtoral.
- të përshkruajnë llojet dhe procedurat e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe riparimeve të lehta të makinat blegtorale.
- të përshkruajnë rregullat për përdorimin e makinave blegtorale.

▪ **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Mjetet e mekanizuara për shërbimet bazë blegtorale” Kl. 13-64 orë**

Tema 1	Rëndësia e mekanizimit të shërbimeve bazë blegtorale	3 orë
Tema 2	Mjetet, pajisjet dhe makineritë për shërbimet bazë blegtorale	5 orë
Tema 3	Mjetet, pajisjet dhe makineritë për pastrimin e komplekseve blegtorale	6 orë
Tema 4	Mjetet, pajisjet dhe makineritë për ushqyerjen e blegtorisë	6 orë
Tema 5	Ndërtimi, funksionimi dhe përdorimi i mjeteve, pajisjeve dhe makinerive për shërbimet të tjera në blegtorale	4 orë
Tema 6	Mënyrat e vënies në punë të pajisjeve, mjeteve dhe makinerive për shërbimet bazë blegtorale	4 orë
Tema 7	Manualet e përdorimit të mjeteve, pajisjeve dhe makinerive për shërbimet bazë blegtorale	5 orë
Tema 8	Defektet e mundshme të mjeteve, pajisjeve dhe makinerive për shërbimet bazë blegtorale	5 orë
Tema 9	Makinat dhe impiantet e mekanizuar në blegtori	8 orë
Tema 10	Ndërtimi, funksionimin dhe përdorimin e makinave dhe impianteve të blegtorisë.	8 orë
Tema 11	Ndërtimi, funksionimi dhe përdorimi i makinave dhe pajisjeve për transportin prodhimit blegtoral	6 orë
Tema 12	Riparimet e thjeshta të mjeteve, pajisjeve dhe makineritë për shërbimet bazë blegtorale	4 orë

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

1. Moduli “Rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit në teknologjinë bujqësore”

Kualifikimi profesional: Teknologji bujqësore

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe Kodi	RREGULLAT E SIGURISË NË PUNË DHE MBROJTJES SË MJEDISIT NË TEKNOLOGJINË BUJQËSORE	M-05-2128-25
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të zbatuar legjislacionin për sigurinë në punë dhe ruajtjen e shëndetit, për dhënien e ndihmës së parë në rastet e nevojshme, si dhe për zbatimin e parimeve të ruajtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qendrueshëm.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II-të i KSHK të kualifikimit profesional “Bujqësi”.	
Rezultatet e të nxënit (RN), procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi zbaton rregullat e sigurisë në punë. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të veshë uniformën profesionale në vendin e punës; – të zbatojë rregulloren e brendshme gjatë përdorimit të makinave dhe pajisjeve bujqësore; – të zbatojë legjislacionin shqiptar për sigurinë dhe shëndetin në punë; – të përdorë manuale teknike të mjeteve dhe pajisjeve të punës; – të zbatojë rregullat e higjienës së mjeteve dhe pajisjeve mbrojtëse dhe vendit të punës; – të zbatojë shenjat dalluese të sinjalistikës në mjedisin e punës; – të përdorë pajisjet mbrojtëse (veshje mbrojtëse, doreza, kaskë, syze mbrojtëse, këpucë të sigurt etj.), sipas rregullores së sigurimit teknik; – të simulojë procedurat e evakuimit për raste emergjence; – të përdorë pajisje të MZSH; – të zbatojë rregulloret përkatëse gjatë përdorimit të preparateve për mbrojtjen e bimëve dhe preparateve mjekësore veterinare; – të marrë masa në rast të mosfunksionimit të mjeteve dhe pajisjeve të punës;

- të bashkëpunojë me institucionet përkatëse për certifikimin e mjeteve, pajisjeve teknike të punës dhe kryerjen e kontrolleve periodike;
- të përdorë dokumentacionin për certifikimin/kalibrimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike të punës, sipas standardeve;
- të informojë stafin për rreziqet e mundshme dhe për mënyrën e reagimit sipas rastit.
- të kujdeset për sigurinë gjatë përdorimit të makinave dhe pajisjeve bujqësore.
- të kryejë trajnimin periodik të stafit për sigurinë në punë.
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të kujdeset për sigurinë gjatë përdorimit të makinave dhe pajisjeve bujqësore.

Instrumentet e vlerësimit

- Pyetje-përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi zbaton rregullat e dhënies së ndihmës së parë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën profesionale në vendin e punës;
- të zbatojë rregulloren e brendshme gjatë përdorimit të makinave dhe pajisjeve bujqësore.
- të kryejë dhënien e ndihmës së parë në rast aksidenti;
- të listojë llojet e mjeteve të ndihmës së parë dhe mënyrat e përdorimit të tyre;
- të kryejë trajnimin e stafit, për mënyrat e dhënies së ndihmës së parë;
- të informojë stafin për rreziqet e mundshme gjatë përdorimit të makinave dhe pajisjeve bujqësore;
- të përdorë kutinë e ndihmës së shpejtë, në rastet e nevojshme;
- të japë ndihmën e parë në rastet sipas rregullit në rastet e dëmtimeve nga përdorimi i makinave dhe pajisjeve bujqësore;
- të njoftojë shërbimin shëndetësor për ndihmë mjeksore, në rast se kërkohet;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë sinjalistikën në vendin e punës;

Instrumentet e vlerësimit

- Pyetje-përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi kujdeset për mjedisin e punës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën profesionale në vendin e punës;
- të zbatojë rregulloren e brendshme gjatë kujdesit për mjedisin e punës;
- të zbatojë parimet e ekonomisë së gjelbër dhe zhvillimit të qëndrueshëm mjedisor;
- të zbatojë politikat e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm;
- të përdorë me efikasitet të burimeve të ujit, energjisë dhe materialeve të tjera, për zhvillim të qëndrueshëm;
- të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit dhe ndarjes së mbetjeve sipas llojit;
- të zbatojë procedurat e menaxhimit të mbetjeve organike (riciklimi, zvogëlimi i mbetjeve etj.) në mjedisin e punës;
- të zbatojë praktikatat e mira bujqësore (përdorimi i plehrave organike, zhvillimi i praktikave bujqësore të qëndrueshme etj.);
- të depozitojë mbetjet organike sipas rregulloreve përkatëse;
- të zbatojë rregullat e sigurisë për magazinimin dhe ruajtjen e materialeve që rrezikojnë ndotjen e mjedisit;
- të zbatojë protokollet e duhura në raste pandemie dhe endemie;
- të kryejë trajnimin e vazhduar të stafit për ruajtjen e mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë profesionale;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në mjedise të shkollës të përshtatura dhe të pajisura me mjetet përkatëse dhe internet për kryerjen e këtyre veprimtarive si dhe mjedise reale të fermave bujqësore.
- Rekomandohen dhe vizita në fermave bujqësore që ofrojnë veprimtari të përdorimit të teknologjisë bujqësore.
- Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave të komunikimit, prezantimit, dhënies së informacionit dhe përdorimit të mjeteve dhe teknikave përkatëse.
- Mësuesi duhet të përdorë metodat e simulimit dhe të lojës me role për praktikimin e nxënësve.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i

	shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e detyrave të dhëna. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të nxëni.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Kompjuter, fotokopje, shërbim interneti dhe programe kompjuterike për të përgatitur dokumentet e nevojshme. - Manuale, udhëzues, materiale të shkruara, video si dhe prezantime në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul. - Bashkëpunim me ferma bujqësore reale që zhvillojnë veprimtari në përdorimin e teknologjisë bujqësore.

2. Moduli “Përdorimi i traktorit me rrota”

Kualifikimi profesional: Teknologji bujqësore

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 12

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PËRDORIMI I TRAKTORIT ME RROTA	M-36-1608-20
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për përdorimin dhe mirëmbajtjen e traktorit me rrota, riparime të thjeshta në to, si dhe kryen llogaritje ekonomike.	
Kohëzgjatja e modulit	75 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK për kualifikimin profesional “Bujqësi”.	
Rezultatet e të nxënit (RN), procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi kryen ecje në fushë, me traktor me rrota. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të veshë uniformën e duhur të punës; – të analizojë dokumentacionin teknik të traktorit me rrota; – të kryejë kontrollin paraprak të gjendjes së traktorit me rrota; – të realizojë hipjen dhe zbritjen nga traktori me rrota sipas udhëzimeve; – të pozicionohet në ndenjësën e traktorit sipas rregullave të përcaktuara; – të rregullojë pozicionin e pasqyrave; – të kryejë ndezjen e traktorit; – të kontrollojë treguesit në kroskotin e traktorit përpara nisjes; – të furnizojë traktorin me lëndë djegëse, ujë apo vaj, në rast nevojë; – të realizojë ndricimin dhe dhënien e sinjaleve gjatë lëvizjes me traktor, siaps rastit; – të bëjë nisjen e traktorit nga vendi, për ecjen para në fushë; – të ecë përpara me traktor, me marshin e parë; – të ndërrojë marshet gjatë ecjes përpara, me shpejtësi të ndryshme; – të bëjë uljen graduale të shpejtësisë dhe frenimin e traktorit; – të bëjë sigurimin me frenin e dorës të traktorit; – të bëjë ecjen mbrapa të traktorit me rrota, në fushë; – të realizojë kthesa të ndryshme të traktorit nga e majta, në fushë;	

- të realizojë kthesa të ndryshme të traktorit nga e djathta, në fushë;
- të bëjë ndalimin, sigurimin me frenin e dorës dhe fikjen e traktorit;
- të kryejë llogaritje ekonomike lidhur me procesin e ecjes me traktor me rrota;
- të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për procesin e ecjes me traktor me rrota;
- të pastrojë dhe sistemojë vendin e punës;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e ecjes në fushë dhe të sigurimit teknik gjatë ecjes me traktor me rrota;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 2 Nxënësi manovron agregatin traktor me rrota-makina bujqësore.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e duhur të punës;
- të analizojë dokumentacionin teknik të traktorit me rrota dhe të makinës bujqësore;
- të kryejë kontrollin paraprak të gjendjes së traktorit me rrota dhe të makinës bujqësore;
- të kryejë ndezjen e traktorit me rrota;
- të furnizojë traktorin me lëndë djegëse, ujë apo vaj, në rast nevojë;
- të manovrojë traktorin me rrota për ta afruar te makina bujqësore;
- të lidhë ganxhën e makinës bujqësore me hallkën lidhëse tripikëshe të mekanizmit varës-hidraulik të traktorit;
- të kryejë lidhjen dhe regjistrimin e stabilizatorëve;
- të realizojë komandimin e mekanizmit varës-hidraulik për vendosjen e makinës në regjime transporti;
- të kryejë transportin e agregatit traktor me rrota-makinë bujqësore në vendin ku do të kryhet punimi bujqësor;
- të realizojë komandimin e mekanizmit varës-hidraulik për vendosjen e makinës në pozicione të ndryshme pune;
- të kryejë transportin e agregatit traktor me rrota - makinë bujqësore në vendin ku do të kryhet parkimi;
- të manovrojë agregatin traktor me rrota - makinë bujqësore për të bërë parkimin e makinës bujqësore;
- të realizojë uljen dhe shkëputjen e makinës bujqësore nga mekanizmi varës-hidraulik i traktorit;
- të parkojë traktorin me rrota;

- të kryejë llogaritje ekonomike lidhur me procesin e manovrimit të agregatit traktor me rrota - makinë bujqësore;
- të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për procesin e manovrimit të agregatit traktor me rrota - makinë bujqësore;
- të pastrojë dhe sistemojë vendin e punës;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e manovrimit të agregatit traktor me rrota - makinë bujqësore dhe të sigurimit teknik gjatë manovrimit;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi kryen punime të mirëmbajtjes dhe të riparimeve të thjeshta në traktorin me rrota.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e duhur të punës;
- të analizojë dokumentacionin teknik të traktorit me rrota;
- të kryejë kontrollin paraprak të gjendjes së traktorit me rrota;
- të kryejë pastrimin e jashtëm të traktorit me rrota;
- të kryejë ndezjen e traktorit me rrota;
- të kontrollojë shtrëngimet e bulonave (dadiçekëve) të rrotave;
- të bëjë përcaktojë parregullsitë e mundshme me anë të dëgjimit të zhurmës gjatë punës së motorit në minimo;
- të kontrollojë dhe rregullojë presionin e ajrit në gomat e traktorit;
- të kontrollojë motorin për rrjedhje të ujit ose të vajit lubrifikues;
- të kontrollojë transmisionin për rrjedhje të vajit lubrifikues;
- të kontrollojë sistemin hidraulik për rrjedhje të vajit hidraulik;
- të verifikojë nivelin lëndës djegëse, ujit, vajit lubrifikues dhe vajit hidraulik;
- të furnizojë traktorin me lëndë djegëse, ujë, vaj lubrifikues dhe vaj hidraulik, në rast nevojë;
- të verifikojë dhe plotësojë nivelin e alkoolit të frenave;
- të kryejë lubrifikimet dhe grasatimet e nevojshme;
- të kryejë shtrëngimet e pjesëve të liruara dhe regjistrimet e nevojshme;
- të kryejë grasatimin e pjesëve të lëvizëshme të traktorit;
- të shtojë antifrizën në depozitën e ujit të sistemit të ftohjes;
- të zëvendësojë filtrat e vajit të motorit;

- të zëvendësojë vajin e motorit;
- të zëvendësojë filtrin e ajrit;
- të zëvendësojë filtrat e lëndës djegëse;
- të zëvendësojë filtrat e sistemit hidraulik;
- të kontrollojë dhe regjistrojë shtrëngimin e rripave në transmisionet me rripa dhe pulexho;
- të kontrollojë shtrëngimet e fashetave të tubave prej gome;
- të zëvendësojë fshirësit e xhamave;
- të zëvendësojë llampat e ndriçuesve dhe sinjalizuesve të traktorit me rrota;
- të përzgjedhë nga katalogu dhe të porositë pjesët e traktorit që do të zëvendësohen;
- të kryejë zëvendësime (që kryhen me lehtësi) të pjesëve të dëmtuara të traktorit;
- të krijojë kushtet e duhura për ruajtjen e traktorit me rrota në vendparkim;
- të kryejë llogaritje ekonomike lidhur me procesin e mirëmbajtjes dhe riparimit të traktorit me rrota;
- të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për procesin e mirëmbajtjes dhe riparimit të traktorit me rrota;
- të pastrojë dhe sistemojë vendin e punës;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë mirëmbajtjes dhe riparimit të traktorit me rrota;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në fermën e shkollës ose në sheshe të lira ku mund të realizohet ecje pa rrezik me traktor me rrota.
 - Mësuesi apo instruktori duhet të përpiqet që rezultatet mësimore të këtij moduli të realizohen në kushtet konkrete të fermës, duke u dhënë mundësi nxënësve të grumbullojnë të gjitha të dhënat që duhet për të analizuar kushtet dhe mundësitë e përdorimit, mirëmbajtjes dhe riparimeve të lehta të traktorit me rrota, si dhe kryen llogaritje ekonomike.
 - Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e demonstrime konkrete të përdorimit, mirëmbajtjes dhe riparimeve të lehta të traktorit me rrota, si dhe llogaritje ekonomike.
 - Nxënësit duhet të praktikohen në veprimtari konkrete pune për të përdorur dhe mirëmbajtur traktorin me rrota, si dhe për të kryer riparime të lehta në të, fillimisht nën mbikqyrje dhe pastaj në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me procedurat e punës të përdorimit, mirëmbajtjes dhe të riparimeve të lehta në traktorin me rrota, si dhe llogaritje ekonomike.
-

	- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e rezultateve mësimore të planifikuara në këtë modul. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Ferma e shkollës, sheshe dhe rrugë për ecje pa rrezim traktorin me rrota. - Traktor me rrota. - Vegla dhe pajisje të mirëmbajtjes së traktorit me rrota. - Vegla dhe pajisje të riparimeve të thjeshta të traktorit me rrota. - Materiale kancelarie. - Informacione të shkruara ose elektronike të siguruar nga burime të ndryshme mbi procedurat e përdorimit, mirëmbajtjes dhe riparimeve të lehta të traktorit me rrota. - Dokumentacion teknik. - Kompjuter dhe lidhje Interneti. - Udhëzues, skema, katalogë, rregullore etj.

3. Moduli “Përdorimi i makinave për punimin e tokës”

Kualifikimi profesional: Teknologji bujqësore

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PËRDORIMI I MAKINAVE PËR PUNIMIN E TOKËS	M-36-1609-25
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të përdorur dhe mirëmbajtur makinat për punimin e tokës, riparime të lehta në to, si dhe kryen llogaritje ekonomike.	
Kohëzgjatja e modulit	78 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK për kualifikimin profesional “Bujqësi” dhe modulën “Përdorimi i traktorit me rrota”.	
Rezultatet e të nxënit (RN), procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi përdor plugjet për punimin e tokës. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të veshë uniformën e duhur të punës; – të vlerësojë gjendjen e tokës për plugim; – të lexojë kartën teknologjike të kulturës bujqësore; – të përzgjedhë mjetin motorik për plugimine tokës në funksion të procesit të punës; – të përzgjedhë plugun për punimin e tokës; – të kontrollojë paraprakisht gjendjen teknike të mjetit motorik dhe të plugut; – të lidhë plugun me mjetin motorik; – të vendosë plugun në regjim për transport; – të transportojë agregatin në vendin ku do të kryhet plugimi i tokës; – të përcaktojë mënyrën optimale, skemën e punimit të tokës dhe regjimet përkatëse të plugimit; – të kryejë regjistrimet e plugut për regjime të ndryshme të plugimit; – të realizojë procesin e plugimit të tokës, sipas mënyrave, skemës dhe regjimeve përkatëse; – të ndryshojë pozicionin e plugut, sipas regjimeve të plugimit; – të realizojë kthesat gjatë mavovrimit me agregatin. – të bëjë kontrollin e vazhdueshëm të cilësisë së punimit të tokës me plug; – të transportojë agregatin në parkim; – të shkëpusë plugun nga mjeti motorik dhe ta parkojë në vendin e duhur;	

- të tregojë kujdes të vazhdueshëm për mjetin motorik dhe plugun;
- të kryejë shërbimet e mirëmbajtjes së përditëshme të mjetit motorik dhe të plugjeve.
- të kryejë riparime të lehta dhe/ose zëvendësime të pjesëve të agregatit, në raste të parregullsive të mundshme;
- të kryejë llogaritje ekonomike për punimin e kryer;
- të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për punimin e kryer;
- të pastrojë dhe sistemojë vendin e punës;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përdorimit të plugjeve për punimin e tokës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 2 Nxënësi përdor disqet për punimin e tokës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e duhur të punës;
- të vlerësojë gjendjen e tokës për diskim;
- të lexojë kartën teknologjike të kulturës bujqësore;
- të përzgjedhë mjetin motorik për diskimine tokës në funksion të procesit të punës;
- të përzgjedhë diskun për punimin e tokës;
- të kontrollojë paraprakisht gjendjen teknike të mjetit motorik dhe të diskut;
- të lidhë diskun me mjetin motorik;
- të vendosë diskun në regjim për transport;
- të transportojë agregatin në vendin ku do të kryhet diskimi tokës;
- të përcaktojë mënyrën optimale, skemën e diskimit të tokës dhe regjimet përkatëse të diskimit;
- të kryejë regjistrimet e diskut për regjime të ndryshme të diskimit;
- të realizojë proceset e diskimit të tokës, sipas mënyrave, skemës dhe regjimeve përkatëse të diskimit;
- të ndryshojë pozicionin e diskut, sipas regjimeve të diskimit;
- të realizojë kthesat gjatë mavovrimit me agregatin.
- të bëjë kontrollin e vazhdueshëm të cilësisë së diskimit të tokës me disk;
- të transportojë agregatin në parkim;
- të shkëpusë diskun nga mjeti motorik dhe ta parkojë në vendin e duhur;
- të tregojë kujdes të vazhdueshëm për mjetin motorik dhe diskun;

- të kryejë shërbimet e mirëmbajtjes së përditshme të mjetit motorik dhe të disqeve;
- të kryejë riparime të lehta dhe/ose zëvendësime të pjesëve të agregatit, në raste të parregullsive të mundshme;
- të kryejë llogaritje ekonomike për punimin e kryer;
- të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për punimin e kryer;
- të pastrojë dhe sistemojë vendin e punës;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përdorimit të disqeve për punimin e tokës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 3 Nxënësi përdor frezat për punimin e tokës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e duhur të punës;
- të vlerësojë gjendjen e tokës për frezim;
- të lexojë kartën teknologjike të kulturës bujqësore;
- të përzgjedhë mjetin motorik për frezimin e tokës në funksion të procesit të punës;
- të përzgjedhë frezën për punimin e tokës;
- të kontrollojë paraprakisht gjendjen teknike të mjetit motorik dhe të frezës;
- të lidhë frezën me mjetin motorik;
- të vendosë frezën në regjim për transport;
- të transportojë agregatin në vendin ku do të kryhet frezimi i tokës;
- të përcaktojë mënyrën optimale, skemën e punimit të tokës dhe regjimet përkatëse të frezimit;
- të kryejë regjistrimet e frezës për regjime të ndryshme të frezimit;
- të realizojë proceset e punimit të tokës, sipas mënyrave, skemës dhe regjimeve përkatëse të punimit;
- të ndryshojë pozicionin e frezës, sipas regjimeve të frezimit;
- të realizojë kthesat gjatë manovrimit me agregatin.
- të bëjë kontrollin e vazhdueshëm të cilësisë së punimit të tokës me frezë;
- të transportojë agregatin në parkim;
- të shkëpusë frezën nga mjeti motorik dhe ta parkojë në vendin e duhur;
- të tregojë kujdes të vazhdueshëm për mjetin motorik dhe frezën;
- të kryejë shërbimet e mirëmbajtjes së përditshme të mjetit motorik dhe të frezave;

- të kryejë riparime të lehta dhe/ose zëvendësime të pjesëve të agregatit, në raste të parregullsive të mundshme;
- të kryejë llogaritje ekonomike për punimin e kryer;
- të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për punimin e kryer;
- të pastrojë dhe sistemojë vendin e punës;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përdorimit të frezave për punimin e tokës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 4 Nxënësi përdor makina të tjera për punime plotësuese të tokës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e duhur të punës;
- të vlerësojë gjendjen e tokës për punime plotësuese;
- të lexojë kartën teknologjike të kulturës bujqësore;
- të përzgjedhë mjetin motorik për punime plotësuese të tokës;
- të përzgjedhë makinën bujqësore për punimin plotësues të tokës (lesa, kultivatori, brana, rul etj);
- të kontrollojë paraprakisht gjendjen teknike të mjetit motorik dhe të makinës bujqësore;
- të lidhë makinën bujqësore me mjetin motorik;
- të vendosë makinën bujqësore në regjim për transport;
- të transportojë agregatin në vendin ku do të kryhet punimi plotësues i tokës;
- të përcaktojë mënyrën optimale, skemën e punimit të tokës dhe regjimet përkatëse të punimit plotësues;
- të kryejë regjistrimet e makinës për regjime të ndryshme të punimit plotësues;
- të realizojë proceset e punimit plotësues të tokës, sipas mënyrave, skemës dhe regjimeve përkatëse të punimit;
- të ndryshojë pozicionin e makinës bujqësore, sipas regjimeve të punimit plotësues;
- të realizojë kthesat gjatë mavovrimit me agregatin.
- të bëjë kontrollin e vazhdueshëm të cilësisë së punimit plotësues të tokës me makinën bujqësore;
- të transportojë agregatin në parkim;
- të shkëpusë makinën nga mjeti motorik dhe ta parkojë në vendin e duhur;
- të tregojë kujdes të vazhdueshëm për mjetin motorik dhe makinën bujqësore;
- të kryejë shërbimet e mirëmbajtjes së përditshme të mjetit motorik dhe të makinave bujqësore;

- të kryejë riparime të lehta dhe/ose zëvendësime të pjesëve të agregatit, në raste të parregullsive të mundshme;
- të kryejë llogaritje ekonomike për punimin e kryer;
- të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për punimin e kryer;
- të pastrojë dhe sistemojë vendin e punës;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përdorimit të makinave të tjera bujqësore për punimin e tokës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 5 Nxënësi kryen punime të mirëmbajtjes dhe të riparimeve të thjeshta në makinat bujqësore për punimin e tokës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë dokumentacionin teknik të makinës bujqësore;
- të kryejë kontrollin paraprak të gjendjes së makinës bujqësore;
- të kryejë pastrimin e jashtëm të makinës bujqësore;
- të kontrollojë shtrëngimet e pjesëve dhe regjistrimet e duhura të mekanizmave;
- të kryejë shtrëngimet e pjesëve të liruar dhe regjistrimet e mekanizmave, në rast nevojë;
- të kryejë lubrifikimet dhe grasatimet e nevojshme të pjesët e lëvizëshme të makinës;
- të për zgjedhë nga katallogu dhe të porositë pjesët e makinës bujqësore që duhet të zëvendësohen;
- të kryejë zëvendësime (që kryhen me lehtësi) të pjesëve të dëmtuara të makinës bujqësore
- të krijojë kushtet e duhura për ruajtjen e makinës bujqësore në vendparkim.
- të kryejë llogaritje ekonomike për punimin e kryer;
- të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për punimin e kryer;
- të pastrojë dhe sistemojë vendin e punës;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë mirëmbajtjes dhe riparimit të makinës bujqësore të punimit të tokës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit	- Ky modul duhet të trajtohet në fermën e shkollës ose ferma bujqësore të rajonit. - Mësuesi apo instruktori duhet të përpiqet që rezultatet mësimore të këtij moduli të realizohen në kushtet konkrete të fermës, duke u dhënë mundësi nxënësve të grumbullojnë të gjitha të dhënat që duhet për të analizuar kushtet dhe mundësitë e përdorimit, mirëmbajtjes dhe riparimeve të lehta të makinave të punimit të tokës, si dhe kryen llogaritje ekonomike . - Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e demonstrime konkretë të përdorimit, mirëmbajtjes dhe riparimeve të lehta të makinave të punimit të tokës, si dhe llogaritje ekonomike. - Nxënësit duhet të praktikohen në veprimtari konkrete pune për të përdorur dhe mirëmbajtur makinat e punimit të tokës, si dhe për të kryer riparime të lehta në to, fillimisht nën mbikqyrje dhe pastaj në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me procedurat e punës të përdorimit, mirëmbajtjes dhe të riparimeve të lehta në makinat e punimit të tokës, si dhe llogaritjeve ekonomike. - Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e rezultateve mësimore të planifikuara në këtë modul. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Ferma e shkollës ose ferma bujqësore të rajonit. - Mjete motorike. - Makina bujqësore: plugje, disqe dhe freza. - Makina të tjera bujqësore si: lesa, kultivatorë brana etj. - Materiale kancelarie. - Informacione të shkruara ose elektronike të siguruar nga burime të ndryshme mbi procedurat e përdorimit, mirëmbajtjes dhe riparimeve të lehta të makinave të punimit të tokës. - Dokumentacion teknik dhe financiar. - Kompjuter dhe lidhje internet. - Udhëzues, katalogë, rregullore etj.

4. Moduli: “Përdorimi i makinave mbjellëse”

Kualifikimi profesional: Teknologji bujqësore

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 12

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PËRDORIMI I MAKINAVE MBJELLËSE	M-36-1610-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson nxënësit për të përdorur dhe mirëmbajtur makinat mbjellëse, riparime të lehta në to, si dhe kryen llogaritje ekonomike.	
Kohëzgjatja e modulit	69 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK për kualifikimin profesional “Bujqësi” dhe modulin “Përdorimi i traktorit me rrota”.	
Rezultatet e të nxënit (RN), dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi përdor makinat mbjellëse me rreshta. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të veshë uniformën e duhur të punës; – të vlerësojë kushtet e tokës për mbjellje; – të përzgjedhë mjetin motorik në përshtatje me makinën mbjellëse me rreshta; – të bëjë kontrollin vizual të makinës mbjellëse me rreshta; – të lidh traktorin me makinën mbjellëse me rreshta; – të regjistrojë makinën mbjellëse për të siguruar normën e farës; – të regjistrojë makinën mbjellëse për të siguruar thellësinë e mbjelljes; – të regjistrojë makinën mbjellëse për të siguruar shpërndarjen e njëtrajtshme të farës; – të bëjë provën stacionare; – të transportojë agregatin në parcelën ku do të kryhet mbjellja e farës; – të përcaktojë skemën optimale të lëvizjes së agregatit; – të bëjë provën fushore për të kontrolluar dhe rregulluar parametrat e mbjelljes; – të realizojë procesin e mbjelljes, sipas mënyrës, skemës dhe regjimeve përkatëse; – të kontrollojë cilësinë e mbjelljes dhe të bëjë korrigjimet e nevojshme; – të realizojë kthesat gjatë mavovrimit me agregatin. – të bëjë kontrollin e vazhdueshëm të cilësisë së mbjelljes; – të transportojë agregatin në parkim;	

- të shkëpusë makinën mbjellëse nga mjete motorik dhe t'i parkojë ato në vendin e duhur;
- të tregojë kujdes të vazhdueshëm për mjetin motorik dhe makinën mbjellëse;
- të kryejë shërbimet e mirëmbajtjes së përditshme të mjetit motorik dhe të makinës mbjellëse.
- të kryejë riparime të lehta dhe/ose zëvendësime të pjesëve të agregatit, në raste të parregullsive të mundshme;
- të kryejë llogaritje ekonomike për punimin e kryer;
- të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për punën e kryer;
- të pastrojë dhe sistemojë vendin e punës;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përdorimit të mjetit motorik dhe makinës mbjellëse me rreshta;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 2 Nxënësi përdor makinat mbjellëse me saktësi.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e duhur të punës;
- të vlerësojë kushtet e tokës për mbjellje;
- të përzgjedhë mjetin motorik në përshtatje me makinën mbjellëse me saktësi;
- të bëj kontrollin vizual të makinës mbjellëse me saktësi;
- të lidh traktorin me makinën mbjellëse me saktësi;
- të regjistrojë makinën mbjellëse me saktësi për të siguruar normën e farës;
- të regjistrojë makinën mbjellëse me saktësi për të siguruar thellësinë e mbjelljes;
- të regjistrojë makinën mbjellëse me saktësi për të siguruar shpërndarjen e njëtrajtshme të farës;
- të bëj provën stacionare;
- të transportojë agregatin në parcelën ku do të kryhet mbjellja e farës;
- të përcaktojë skemën optimale të lëvizjes së agregatit;
- të bëj provën fushore për të kontrolluar thellësinë e mbjelljes;
- të realizojë procesin e mbjelljes, sipas parametrave të mbjelljes;
- të kontrollojë dhe korrigjojë cilësinë e mbjelljes;
- të realizojë kthesat gjatë mavovrimit me agregatin.
- të bëjë kontrollin e vazhdueshëm të cilësisë së mbjelljes;
- të transportojë agregatin në parkim;

- të shkëpusë makinën mbjellëse me saktësi nga mjeti motorik dhe t'i parkojë ato në vendin e duhur;
- të tregojë kujdes të vazhdueshëm për mjetin motorik dhe makinën mbjellëse;
- të kryejë shërbimet e mirëmbajtjes së përditshme të mjetit motorik dhe të makinës mbjellëse me saktësi.
- të kryejë riparime të lehta dhe/ose zëvendësime të pjesëve të agregatit, në raste të parregullsive të mundshme;
- të kryejë llogaritje ekonomike lidhur me punimet e kryera;
- të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për punën e kryer;
- të pastrojë dhe sistemojë vendin e punës;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përdorimit të mjetit motorik dhe makinës mbjellëse me saktësi;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 3 Nxënësi përdor makinat mbjellëse të patates.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e duhur të punës;
- të vlerësojë kushtet e tokës për mbjelljen e patates;
- të përzgjedhë mjetin motorik në përshtatje me makinën mbjellëse të patates;
- të bëjë kontrollin vizual të makinës mbjellëse të patates
- të lidhë traktorin me makinën mbjellëse të patates;
- të regjistrojë për punë makinën mbjellëse për të siguruar normën e farës;
- të bëjë provën stacionare;
- të transportojë agregatin në parcelën ku do të kryhet mbjellja e farës së patates;
- të përcaktojë skemën optimale të lëvizjes së agregatit;
- të bëjë provën fushore për të kontrolluar parametrat e mbjelljes;
- të realizojë procesin e mbjelljes, sipas mënyrës, skemës dhe regjimeve përkatëse të mbjelljes;
- të kontrollojë dhe korrigjojë cilësinë e mbjelljes së patates;
- të realizojë kthesat gjatë mavovrimit me agregatin.
- të bëjë kontrollin e vazhdueshëm të cilësisë së mbjelljes së patates;
- të transportojë agregatin në parkim;
- të shkëpusë makinën mbjellëse nga mjeti motorik dhe t'i parkojë ato në vendin e duhur;

- të tregojë kujdes të vazhdueshëm për mjetin motorik dhe makinën mbjellëse;
- të kryejë shërbimet e mirëmbajtjes së përditshme të mjetit motorik dhe të makinës mbjellëse;
- të kryejë riparime të lehta dhe/ose zëvendësime të pjesëve të agregatit, në raste të parregullsive të mundshme;
- të kryejë llogaritje ekonomike për punimet e kryera;
- të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për punën e kryer;
- të pastrojë dhe sistemojë vendin e punës;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përdorimit të mjetit motorik dhe makinës mbjellëse të patates;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 4 Nxënësi përdor makinat mbjellëse të fidanëve.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e duhur të punës;
- të vlerësojë kushtet e tokës për mbjellje të fidanëve;
- të përzgjedhë mjetin motorik në përshtatje me makinën mbjellëse të fidanëve;
- të bëjë kontrollin vizual të makinës mbjellëse të fidanëve
- të lidh traktorin me makinën mbjellëse të fidanëve;
- të regjistrojë makinën mbjellëse të fidanëve për të siguruar normën e fidanëve;
- të regjistrojë makinën mbjellëse për të siguruar thellësinë e mbjelljes së fidanëve të përcaktuar;
- të bëjë provën stacionare;
- të transportojë agregatin në parcelën ku do të kryhet mbjellja e fidanëve;
- të përcaktojë skemën optimale të lëvizjes së agregatit;
- të bëjë provën fushore për të kontrolluar parametrat e mbjelljes së fidanëve;
- të realizojë procesin e mbjelljes, sipas parametrave të mbjelljes;
- të kontrollojë dhe korrigjojë cilësinë e mbjelljes së fidanëve;
- të realizojë kthesat gjatë mavovrimit me agregatin.
- të bëjë kontrollin e vazhdueshëm të cilësisë së mbjelljes;
- të transportojë agregatin në parkim;
- të shkëpusë makinën mbjellëse të fidanëve nga mjeti motorik dhe t'i parkojë ato në vendin e duhur;

- të tregojë kujdes të vazhdueshëm për mjetin motorik dhe makinën mbjellëse të fidanëve;
- të kryejë shërbimet e mirëmbajtjes së përditshme të mjetit motorik dhe të makinës mbjellëse të fidanëve.
- të kryejë riparime të lehta dhe/ose zëvendësime të pjesëve të agregatit, në raste të parregullsive të mundshme;
- të kryejë llogaritje ekonomike për punimet e kryera;
- të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për punën e kryer;
- të pastrojë dhe sistemojë vendin e punës;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përdorimit të mjetit motorik dhe makinës mbjellëse të fidanëve;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 5 Nxënësi kryen punime të mirëmbajtjes dhe të riparimeve të thjeshta në makinat mbjellëse.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë dokumentacionin teknik të makinës mbjellëse;
- të kryejë kontrollin paraprak të gjendjes së makinës mbjellëse;
- të kryejë pastrimin e jashtëm të makinës mbjellëse;
- të kontrollojë shtrëngimet e pjesëve dhe regjistrimet e duhura të mekanizmave;
- të kryejë shtrëngimet e pjesëve të liruara dhe regjistrimet e mekanizmave, në rast nevojë;
- të kryejë lubrifikimet dhe gratatimet e nevojshme të pjesët e lëvizëshme të makinës mbjellëse;
- të përzgjedhë nga katallogu dhe të porositë pjesët e makinës mbjellëse që duhet të zëvendësohen;
- të kryejë zëvendësime (që kryhen me lehtësi) të pjesëve të dëmtuara të makinës mbjellëse;
- të krijojë kushtet e duhura për ruajtjen e makinës mbjellëse në vendparkim;
- të kryejë llogaritje ekonomike;
- të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për punën e kryer;
- të pastrojë dhe sistemojë vendin e punës;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;

- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë mirëmbajtjes dhe riparimit të makinës mbjellëse;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në fermën e shkollës ose ferma bujqësore të rajonit.
 - Mësuesi apo instruktori duhet të përpiqet që rezultatet mësimore të këtij moduli të realizohen në kushtet konkrete të fermës, duke u dhënë mundësi nxënësve të grumbullojnë të gjitha të dhënat që duhet për të analizuar kushtet dhe mundësitë e përdorimit, mirëmbajtjes dhe riparimeve të lehta të makinave mbjellëse, si dhe kryen llogaritje ekonomike.
 - Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e demonstrime konkretë të përdorimit, mirëmbajtjes dhe riparimeve të lehta të makinave mbjellëse, si dhe llogaritjeve ekonomike.
 - Nxënësit duhet të praktikohen në veprimtari konkrete pune për të përdorur dhe mirëmbajtur makinat mbjellëse, si dhe për të kryer riparime të lehta në to, fillimisht nën mbikqyrje dhe pastaj në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me procedurat e punës të përdorimit, mirëmbajtjes dhe të riparimeve të lehta në makinat mbjellëse, si dhe llogaritje ekonomike.
 - Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e rezultateve mësimore të planifikuara në këtë modul.
 - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
-

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Ferma e shkollës ose ferma bujqësore të rajonit.
 - Mjete motorike bujqësore.
 - Makina mbjellëse me rreshta.
 - Makina mbjellëse me saktësi.
 - Makina mbjellëse të patates.
 - Makina mbjellëse e fidanëve.
 - Vegla dhe pajisje të thjeshta për mirëmbajtje dhe riparim të makinave mbjellëse.
 - Materiale kancelarie.
 - Informacione të shkruara ose elektronike të siguruar nga burime të ndryshme mbi procedurat e përdorimit, mirëmbajtjes dhe riparimeve të lehta të makinave mbjellëse.
 - Dokumentacion teknik dhe financiar.
 - Kompjuter dhe lidhje internet.
 - Udhëzuesa, katalogë, rregullore etj.
-

5. Moduli “Përdorimi i makinave dhe pajisjeve për shërbimin e bimëve”

Kualifikimi profesional: Teknologji bujqësore

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 12

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PËRDORIMI I MAKINAVE DHE PAJISJEVE PËR SHËRBIMIN E BIMËVE	M-36-2129-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për të përdorur dhe mirëmbajtur makinat për shërbimin e bimëve, riparimet e lehta në to, si dhe kryen llogaritje ekonomike.	
Kohëzgjatja e modulit	72 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK për kualifikimin profesional “Bujqësi” dhe modulin “Përdorimi i makinave mbjellëse”.	
Rezultatet e të nxënit (RN), procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi përdor aparatet spërkatëse të shpinës për trajtimin e bimëve. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të veshë uniformën e duhur të punës; – të lexojë dhe zbatojë udhëzimet për spërkatjen; – të përzgjedhë pompën e shpinës me të cilën do të kryejë trajtimet; – të transportojë pompën e shpinës në vendin ku do të kryhet trajtimi; – të përgatisë solucionin e trajtimit; – të realizojë proceset e spërkatjes, sipas parametrave të duhur; – të tregojë kujdes të vazhdueshëm gjatë përdorimit të pompës së shpinës; – të bëjë riparime të thjeshta të pompës spërkatëse; – të transportojë pompën spërkatëse të shpinës në magazinë; – të pastrojë me ujë pompën sipas udhëzimeve; – të derdhë ujin në vendin e caktuar; – të kryejë llogaritje ekonomike për trajtimin e kryer; – të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për punimin e kryer; – të pastrojë dhe sistemojë vendin e punës; – të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup; – të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;	

- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përdorimit të aparateve spërkatëse të shpinës për trajtimin e bimëve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi përdor makinat spërkatëse për trajtimin e bimëve.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e duhur të punës;
- të lexojë dhe zbatojë udhëzimet për spërkatjen;
- të përzgjedhë mjetin motorik në funksion të procesit të spërkatjes;
- të përzgjedhë makinën për spërkatjen e bimëve;
- të kontrollojë paraprakisht gjendjen teknike të mjetit motorik dhe të makinëspërkatëse;
- të përgatisë tretësirën për spërkatje;
- të bëjë regjistrimin e makinës spërkatëse për të siguruar dozën e spërkatjes;
- të regjistrojë makinën spërkatëse për të siguruar shpërndarje uniforme të spërkatjes;
- të bëjë provën stacionare për sigurimin e parametrave të spërkatjes;
- të lidhë makinën spërkatëse me mjetin motorik;
- të vendosë makinën spërkatëse në regjim për transport;
- të transportojë agregatin në vendin ku do të kryhet trajtimin e bimëve;
- të përcaktojë skemën optimale të lëvizjes së agregatit,;
- të kryejë regjistrimet e makinës për spërkatje;
- të realizojë proceset e spërkatjes, sipas parametrave të spërkatjes;
- të ndryshojë pozicionin e agregatit, sipas regjimit të spërkatjes;
- të realizojë kthesat gjatë mavovrimit me agregatin.
- të bëjë kontrollin e vazhdueshëm të cilësisë së pulverizimit sipas kartës teknologjike;
- të transportojë agregatin në parkim;
- të shkëpusë makinën spërkatëse nga mjeti motorik dhe t'i parkojë ato në vendin e duhur;
- të tregojë kujdes të vazhdueshëm për mjetin motorik dhe makinën spërkatëse;
- të kryejë shërbimet e mirëmbajtjes së përditshme të mjetit motorik dhe të makinës spërkatëse;
- të pastrojë me ujë makinën sipas udhëzimeve;
- të derdhë ujin në vendin e caktuar;
- të kryejë riparime të lehta dhe/ose zëvendësime të pjesëve të agregatit, në raste të parregullsive të mundshme;
- të kryejë llogaritje ekonomike për trajtimin e kryer;
- të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për punimin e kryer;

- të pastrojë dhe sistemojë vendin e punës;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- Nxënësit duhet të praktikohen në veprimtari konkrete pune për të përdorur dhe mirëmbajtur motokultivatorin, si dhe për të kryer riparime të lehta në to, fillimisht nën mbikqyrje dhe pastaj në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me procedurat e punës të përdorimit, mirëmbajtjes dhe të riparimeve të lehta në motokultivator, si dhe llogaritjeve ekonomike.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e rezultateve mësimore të planifikuara në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Ferma e shkollës ose fermë bujqësore e rajonit.
 - Motokultivator
 - Makina bujqësore
 - Pjesë këmbimi, vaj lubrifikues, graso, lëndë djegëse
 - Informacione të shkruara ose elektronike të siguruar nga burime të ndryshme mbi procedurat e përdorimit, mirëmbajtjes dhe riparimeve të lehta të motokultivatorëve.
 - Dokumentacion teknik dhe financiar.
 - Kompjuter të lidhur me internet, udhëzues, katalog, etj.
-

4. Moduli “Inventarizimi i fermës”

Kualifikimi profesional: Teknologji bujqësore

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 12

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	INVENTARIZIMI I FERMËS	M-17-2135-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson nxënësit për të kryer veprimet për inventarizimin, hartimin e inventarit dhe kontrollin e elementeve pasurore të fermës bujqësore, si dhe për të kryer llogaritje ekonomike lidhur me inventarizimin e fermës.	
Kohëzgjatja e modulit	54 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK për kualifikimin profesional “Bujqësi” dhe modulet e këtij niveli.	
Rezultatet e të nxënit (RN), procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi kryen procesin e inventarizimit të fermës bujqësore. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të përzgjedhë mjetet, materialet dhe pajisjet e nevojshme për kryerjen e procesit të inventarizimit të elementëve pasurore të fermës bujqësore; – të përcaktojë qartë metodikën që do të ndiqet për kryerjen e procesit të inventarizimit; – të zbatojë fazat nëpër të cilat kalon procesi i inventarizimit të elementëve pasurore të fermës; – të përzgjedhë personin e duhur përgjegjës dhe hartojë listën e detyrave që duhet të përmbushë ai, gjatë inventarizimit; – të përcaktojë, në bazë të planit/urdhërit, sektorët ose pasuritë që do t'i nënshtrohen inventarizimit, në rastin e inventarizimit të pjesshëm; – të kryejë, me saktësi dhe brenda tolerancave, të gjitha matjet, numërimet dhe peshimin e elementeve të pasurisë së fermës bujqësore; – të listojë në mënyrë sistematike elementet e inventarizuara të pasurisë së fermës bujqësore; – të kryejë llogaritje ekonomike lidhur me procesin e inventarizimit të fermës bujqësore; – të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për procesin e inventarizimit; – të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup; – të pastrojë dhe sistemojë vendin e punës;

- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë kryerjes së procesit të inventarizimit;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes mjedisit gjatë kryerjes së procesit të inventarizimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi harton inventarin.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë mjetet, materialet dhe pajisjet e nevojshme për kryerjen e procesit të inventarizimit të elementëve pasurore të fermës bujqësore;
- të konceptojë qartë pasqyrën e inventarit, që do të përdoret për pasqyrimin e rezultateve të inventarizimit;
- të hartojë pasqyrën e inventarit sipas llojit;
- të grupojë saktë elementet pasurore të inventarizuara sipas llojeve të tyre;
- të mbartë me saktësi rezultatet e inventarizimit në pasqyrën e inventarit;
- të bëjë vlerësimin me saktësinë e kërkuar, të elementeve pasurore në inventar;
- të llogarisë saktë vlerën e pasurisë së fermës;
- të kryejë llogaritje ekonomike lidhur me hartimin e inventarit;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të pastrojë dhe sistemojë vendin e punës;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë hartimit të inventarit;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes mjedisit gjatë hartimit të inventarit të fermës bujqësore;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 3 Nxënësi kontrollon përdorimin e pasurisë së fermës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë veglat, materialet dhe pajisjet e nevojshme për kryerjen e procesit të inventarizimit të elementëve pasurore të fermës bujqësore;
- të llogarisë saktë vlerën e pasurisë, duke u bazuar në inventare të viteve të kaluara dhe dokumente, që vërtetojnë shtim ose pakësim të saj gjatë vitit;
- të krahasojë, për çdo element, vlerën e pasurisë sipas dokumenteve, me atë sipas inventarit;

- të evidentojë qartë diferencat eventuale në elementë të ndryshme pasurore;
- të kontrollojë saktësinë e dokumenteve dhe hartimin e inventarëve, duke evidentuar qartë gabimet e mundshme;
- të përcaktojë përgjegjësinë për keqadministrimin e pasurisë dhe personat që do të dëmshpërblejnë dëmtimet e shkaktuara.
- të kryejë llogaritje ekonomike lidhur me kontrollin e përdorimit të pasurisë së fermës bujqësore.
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të pastrojë dhe sistemojë vendin e punës;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes mjedisit gjatë krahasimit të gjëndjes faktike me atë sipas dokumenteve duke kontrolluar mirëpërdorimin e pasurisë së fermës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikant profesional, zyra mësimore si dhe në ferma bujqësore.
- Mësuesi duhet të informojë nxënësit në lidhje me elementët pasurorë të fermës t'i orientojë ata për mënyrën e realizimit të procesit të inventarizimit, mënyrën e hartimit të inventarëve si dhe të veprojnë për të kontrolluar përdorimin e pasurisë së fermës.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të realizuar procesin e inventarizimit, hartuar inventarin dhe krahasimin e gjëndjes faktike me atë sipas dokumenteve duke kontrolluar përdorimin e pasurisë së fermës.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës në fermë, duke e krahasuar atë me praktikën mësimore në shkollë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për realizimin e procesit të inventarizimit, mënyrën e hartimit të inventarëve si dhe për të realizuar kontrollin e përdorimit e pasurisë së fermës.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Zyrë mësimore (kabineti) ose fermë reale.
 - Modele inventarësh të marra nga ferma reale.
 - Kompjuter.
 - Formularë dokumentash model të formuluar nga mësuesi.
 - Materiale mësimore të lëndës “Njohuri ekonomike” lidhur me tematikat përkatëse.
 - Manualët e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.

- Përmbledhje e legjislacionit në fushën e agrobiznesit (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
- Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal

Moduli “Shoqëria e nxënësve”

Kualifikimi profesional: Shërbime kujdesi për të moshuar

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 12^{të}

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	SHOQËRIA E NXËNËSVE	M-17-2199-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të krijuar një shoqëri/ kompani biznesi, për të: kryer procedurat e zgjedhjeve për drejtues e personel, analizuar produktin, kryer proceset e shitjes dhe blerjes, për të promovuar produktin e shoqërisë/ kompanisë, si dhe për të kryer regjistrime të thjeshta dhe përgatitjen e raportit përfundimtar.	
Kohëzgjatja e modulit	54 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar klasën e 11 ^{të} , niveli II i KSHK, për kualifikimin profesional “Bujqësi”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi krijon shoqëri/ kompani. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të kryejë studimin fillestar të tregut për krijimin e një shoqërie/ kompanie; - të përcaktojë qartë qëllimin e veprimtarisë së shoqërisë/ kompanisë; - të përcaktojë qartë llojin e biznesit (tregti, prodhim, shërbim etj.), si dhe fushën ekonomike në të cilën do të zhvillohet veprimtaria; - të vendosë emrin e shoqërisë/ kompanisë, duke pasur parasysh veprimtarinë dhe qëllimin e saj; - të përcaktojë qartë misionin dhe vizionin në lidhje me veprimtarinë dhe identitetin e shoqërisë/ kompanisë; - të përzgjedhë formën juridike më të përshtatshme, në varësi të mundësive të financimit dhe kërkesave të pronarëve; - të hartojë dokumentet themelore juridik (statuti/ rregullore ose akt themelimi);	

-
- të regjistrojë shoqërinë/ kompaninë në Qendrën Kombëtare të Bizneseve (QKB);

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi kryen procedurat e zgjedhjeve për drejtues dhe personel.

Kriteret e vlerësimit

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të planifikojë një proces zgjedhor/ rekrutimi transparent (kandidatët, mënyrën e votimit, afatet, rregullat etj.);
- të ndjekë një rend dhe strukturë të caktuar në organizimin e votimeve (në asamblenë e aksionerëve);
- të hartojë një rregullore të qartë dhe të thjeshtë për funksionimin e departamenteve të shoqërisë/ kompanisë;
- të prezantojë rregullat për zgjedhjen në departamente;
- të prezantojë rolet që duhet të mbulojnë kandidatët e propozuar, sipas departamenteve;
- të respektojë mendimin e shumicës dhe kur ai nuk përputhet me preferencat personale;
- të zgjedhë personin e duhur për drejtues / personel, sipas aftësive për rolin;
- të vlerësojë cilësitë e liderit (motivimin, përgjegjshmërinë, korrektësinë, përkushtim etj.);
- të përdorë mënyra të ndryshme ndërmjetësimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;
- të kontribuojë për një atmosferë bashkëpunuese, gjatë procesit zgjedhor;
- të pranojë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për drejtues dhe personel.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi analizon produktin e përzgjedhur objekt i veprimtarisë së shoqërisë/ kompanisë.

Kriteret e vlerësimit

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë qëllimin kryesor dhe dytësorë të studimit të tregut;
- të përcaktojë objektivat e studimit të tregut;
- të përcaktojë metodën bazë për studimin e tregut;
- të krijojë grupin e punës për studimin e tregut dhe të ndajë detyrat në grup;
- të përzgjedhë metodat kryesore dhe burimet e mbledhjes së të dhënave (intervista, pyetësorë, hulumtim on-line etj.);
- të përgatitë pyetësorët për mbledhjen e të dhënave të tregut;
- të realizojë me kujdes dhe saktësi intervistimet në funksion të objektit të studimit të tregut;
- të kryejë përpunimin paraprak të të dhënave, duke i seleksionuar ato;
- të kryejë përpunimin statistikor dhe analizën përmbajtësore të të dhënave;

- të përgatitë rezultatet e studimit të tregut (gjetjet dhe propozimet);
- të hartojë planin e biznesit duke:
- prezantuar qartë idenë dhe përshkruar në mënyrë të detajuar sipërmarrjen;
- përshkruar qartë prodhimin/ tregtimin;
- përcaktuar karakteristikat që dallojnë ofertën e shoqërisë/ kompanisë së tij nga ajo e konkurrentëve;
- përcaktuar vendndodhjen, ku do të zhvillojë aktivitetin biznesi i saj;
- përcaktuar politikat që ndiqen për produktin apo shërbimin;
- pasqyruar tabelat për shpenzimet e parashikuara dhe të ardhurat e pritshme;
- përcaktuar burimet financiare që nevojiten për të kryer investimet fillestare;
- përshkruar se si do të organizohet biznesi, duke specifikuar numrin e të punësuarve, llojin e kontratave dhe kostot relative;
- të kontrollojë përfundimisht strukturën dhe korrektësinë e përmbajtjes së planit të biznesit;
- të vlerësojë cilësinë, dobishmërinë dhe përputhjen e produktit me nevojat e tregut;
- të vlerësojë përfitimet dhe kufizimet e produktit;
- të vlerësojë mendimet e përdoruesve/ testuesve të produkteve;
- të përmirësojë vazhdimisht produktin, sipas analizimeve të bëra.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi kryen proceset e blerjes/ shitjes.

Kriteret e vlerësimit

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë nevojat për blerje për fillimin e aktivitetit;
- të evidentojë furnitorët potencialë në fushën e biznesit;
- të analizojë furnitorët ekzistues;
- të kontaktojë furnitorët potencialë dhe të sigurojë informacione për ta;
- të zbatojë rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal, gjatë komunikimit me furnitorët;
- të kërkojë oferta e lista çmimesh për artikuj;
- të krahasojë ofertat e furnitorëve potencialë dhe të evidentojë ofertën më të përshtatshme për biznesin;
- të hartojë planin e blerjes dhe të ndjekë realizimin e tij;
- të ndjekë hapat e duhura, gjatë procesit të blerjes;
- të plotësojë dokumentacionin e nevojshëm që përdoret, gjatë procesit të blerjes;
- të kërkojë me kujdes informacione për klientët potencialë;
- të përpunojë kërkesat e klientëve;
- të hartojë listat e çmimeve për klientët;
- të hartojë oferta të ndryshme;
- të pranojë, kontrollojë dhe regjistrojë saktë, porositë e mbërritura nga klientët;

- të plotësojë dokumentacionin e nevojshëm, gjatë procesit të shitjes;
- të kryejë kontrollin e gjendjes fizike të produkteve për shitje;
- të përgatitë produktin për shpërndarje;
- të ambalazhojë produktin, sipas rastit;
- të përzgjedhë kushtet e lëvrimit dhe pagesës që i përshtaten më mirë shoqërisë/ kompanisë, qëllimeve dhe kushteve të veprimtarisë së saj;
- të hartojë saktë faturat e shitjes së mallrave;
- të hartojë refuzimet e shitjeve për arsye dhe në situata të ndryshme;
- të zgjidhë situatat në raste ankesash nga klientët;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit, gjatë blerjes/ shitjes.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Nxënësi kryen promovimin e produktit të shoqërisë/ kompanisë.

Kriteret e vlerësimit

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë produktin të cilit do t'i bëhet marketingu;
- të identifikojë lloje të ndryshme të platformave digjitale dhe mediale sociale;
- të analizojë kriteret për përzgjedhjen e platformës digjitale dhe medias sociale;
- të përzgjedhë platformën digjitale dhe median sociale;
- të prezantojë platformën digjitale dhe median sociale të përzgjedhur;
- të përgatitë materiale të ndryshme interaktive (tekst, imazh, video etj.);
- të hartojë fletëpalosje dhe materiale të tjera reklamuese dhe informuese;
- të hartojë kartëvizitat e materiale të tjera informative për shoqërinë/ kompaninë dhe personelin e saj;
- të ndërtojë video, duke përdorur programe (software) të ndryshme (Movie maker ose nëpërmjet aparatit celular, smartphone etj.);
- të modifikojë imazhe të ndryshme me software (photoshop, canva etj.);
- të ngarkojë (publikojë) materialet e mësipërme në platformën digjitale dhe median sociale të përzgjedhur;
- të përgatitë një plan orar, ditor dhe javor në lidhje me promovimin e produkteve të shoqërisë/ kompanisë;
- të krijojë fushata marketingu, duke përdorur burime të ndryshme reklamimi (rrjetet sociale, e-mail ose mobile marketing);
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm, gjatë promovimit të produktit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 6 Nxënësi harton dhe analizon raportin vjetor.

Kriteret e vlerësimit

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të hartojë një pasqyrë të thjeshtë financiare të mjeteve, detyrimeve dhe kapitalit të vetë shoqërisë/ kompanisë;
- të evidentojë saktë se cilët dokumente do të përdoren për regjistrimin dhe pasqyrimin e veprimtarisë;
- të hartojë saktë dokumentet që mund të përdoren në shoqëri/ kompani (ditarin, librin e arkës, libër i magazinës etj.);
- të regjistrojë gjendjen në dokumentet financiare përkatës;
- të regjistrojë saktë derdhjet e aksionerëve në para dhe në natyrë, sipas llojeve;
- të regjistrojë saktë derdhjet e kapitalit të nënshkruar në fillim dhe gjatë veprimtarisë së shoqërisë/ kompanisë;
- të regjistrojë saktë shumat e shpenzimeve të paguara paraprakisht për krijimin, regjistrimin, asistencën ligjore, si dhe për zgjerimin e veprimtarisë ose ndryshimin e formës juridike;
- të regjistrojë blerjet dhe shitjet e kryera;
- të regjistrojë saktë shpenzimet e punës, detyrimet ndaj personelit, sigurimeve dhe shtetit për TAP, duke u bazuar në listëpagesën e pagave;
- të deklarojë në afatin e duhur detyrimet ndaj shtetit;
- të kryejë saktë mbylljen e llogarive të të ardhurave dhe shpenzimeve;
- të evidentojë rezultatin ekonomik të shoqërisë/ kompanisë;
- të prezantojë rezultatin përfundimtar të shoqërisë/ kompanisë;
- të marrë vendim për shpërndarjen e dividendit, bazuar në përqindjen të aksioneve;
- të kryejë veprimet për likuidimin përfundimtar të shoqërisë/ kompanisë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në shkollë/ klasë dhe në biznes.
- Mësimdhënësi duhet të kryejë demonstrime konkrete lidhur me hapat që ndiqen për: krijimin e një shoqërie/ kompanie biznesi, zbatimin e procedurave të zgjedhjeve për drejtues e personel, analizimin e produktit, realizimin e proceseve të shitjes dhe blerjes, promovimin e produktit të shoqërisë/ kompanisë, si dhe për të kryer regjistrime të thjeshta dhe përgatitjen e raportit përfundimtar.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë lidhur me krijimin e një shoqërie/ kompanie biznesi, zbatimin e procedurave të zgjedhjeve për drejtues e personel, analizimin e produktit, realizimin e proceseve të shitjes dhe të blerjes, promovimin e produktit të shoqërisë/ kompanisë, si dhe për të kryer regjistrime të thjeshta dhe përgatitjes së raportit përfundimtar.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet t'i vihet theksi verifikimit të

	shkallës së arritjeve të shprehive praktike për krijimin e një shoqërie/ kompanie biznesi, zbatimin e procedurave të zgjedhjeve për drejtues e personel, analizimin e produktit, realizimin e proceseve të shitjes dhe të blerjes, promovimin e produktit të shoqërisë/ kompanisë, si dhe për të kryer regjistrime të thjeshta dhe përgatitjes së raportit përfundimtar. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënës.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Udhëzuesi i mësuesit. - Udhëzuesi i nxënësit. - Model statuti dhe akt themelimi. - Modele pasqyrash financiare. - Model letra me vlerë/ aksione. - Libër i arkës. - Libër/ kartela magazine. - Model pyetësori. - Formularë të porosive të shitjeve. - Formularë raportimi. - Materiale kancelarie. - Certifikatat e arritjeve. - Kompjuter/ Lap top. - Projektor. - Internet. - USB dhe CD.

XI. PROGRAMI ORIENTUES PËR PROVIMIN PËRFUNDIMTAR

NË KUALIFIKIMIN PROFESIONAL “TEKNOLOGJI BUJQËSORE”,

Niveli IV i KSHK

TIRANË, 2025

Në përfundim të nivelit të III-të në kualifikimin profesional “Teknologji bujqësore”, Niveli IV i KSHK, nxënësit i nënshtrohen Provimit Përfundimtar të praktikës profesionale të integruar.

- **Programi orientues** për provimet përfundimtare të kualifikimit profesional “Teknologji bujqësore”, përmban kompetencat më të rëndësishme dhe më përfaqësuese për këtë kualifikim, të trajtuara në modulet e detyruara të praktikës profesionale në klasën e 12-të dhe 13-të, që i përket këtij niveli.
- **Lista e kompetencave profesionale** për të cilat duhet të vlerësohen nxënësit, **detyra komplekse e punës** dhe **pikët** për secilën kompetencë:

Nr	Kompetenca profesionale	Detyrat e punës	Pikët
1	Të përdorë traktorin me rrota.	Detyra 1: Realizimi i përdorimit të traktorit me rrota: kryen ecje në fushë, manovron agregatin traktor me rrota-makina bujqësore, kryen punime të mirëmbajtjes dhe riparime të thjeshta në traktorin me rrota.	10
2	Të përdorë makinat për punimin e tokës.	Detyra 2: Realizimi i një prej proceseve të punës për punimin e tokës duke përdorur, plugjet për punimin e tokës, disqet për punimin e tokës, frezat për punimin e tokës, makina të tjera për punime plotësuese të tokës, kryen punime të mirëmbajtjes dhe të riparimeve të thjeshta në makinat bujqësore për punimin e tokës.	10
3	Të përdorë makinat mbjellëse.	Detyra 3: Realizimi i një prej proceseve të punës duke përdorur, makinat mbjellëse me	15

		rreshta, makinat mbjellëse me saktësi, makinat mbjellëse të patates, makinat mbjellëse të fidanëve, kryen punime të mirëmbajtjes dhe të riparimeve të thjeshta në makinat mbjellëse.	
4	Të përdorë makinat dhe pajisjet për shërbimin e bimëve.	Detyra 4: Realizimi i një prej proceseve të punës duke përdorur, aparatet spërkatëse të shpinës për trajtimin e bimëve, makinat spërkatëse për trajtimin e bimëve, makinat pluhuruese për trajtimin e bimëve, makinat për shpërndarjen e plehut organik të ngurtë, makinat për shpërndarjen e plehut kimik të ngurtë, kryen punime të mirëmbajtjes dhe të riparimeve të thjeshta në makinat për shërbimin e bimëve.	15
5	Të përdorë makinat dhe pajisjet për korrjen/ vjeljen dhe mbledhjen e prodhimit.	Detyra 5: Realizimi i një prej proceseve të punës duke përdorur, makinat për kositjen e foragjereve, makinat për tharjen dhe mbledhjen e foragjereve, autokombajna për vjeljen e grurit dhe misrit, makina vjelëse të drufrutorëve, makina vjelëse të fruttrënjorëve.	10
6	Të përdorë makinat për përpunimin, magazinimin dhe ruajtjen e prodhimit	Detyra 6: Realizimi i një prej proceseve të punës duke përdorur, makinat për tharjen e prodhimit, trioret për pastrimin e prodhimit, mullinjtë e bluarjes për blegtorinë, makinat grirëse të silazhit makina të tjera të përpunimit të prodhimit, kryen mirëmbajtjen dhe riparimin e makinave për përpunimin, ruajtjen dhe magazinimin e prodhimit.	15
7	Të kryejë shitblerjen e mjeteve, pajisjeve dhe makinerive bujqësore	Detyra 7: Realizimi i një prej proceseve të punës duke vendosur marrëdhënie me furnitorët, blerjet dhe plotëson dokumentacionin përkatës, vendos marrëdhënie me klientët, kryen shitjen e mjeteve, pajisjeve dhe makinerive bujqësore dhe plotëson dokumentacionin përkatës, kryen blerje dhe shitje në Web-shop.	15
8	Të përdorë makinat blektorale.	Detyra 8: Realizimi i proceseve të punës duke përdorur dhe mirëmbajtur makina mjelëse portative, përdor dhe mirëmban pajisje për qethjen e bagëtive, përdor dhe mirëmban	10

		impiantet e mekanizuara në komplekset blegtorale.	
Shuma			100

b) Skema e vlerësimit me nota:

Pikët e fituara	Notat
0 - 40	4
41 - 50	5
51 - 60	6
61 - 70	7
71 - 80	8
81 - 90	9
91 - 100	10

Shënime:

- Provimi praktik do të realizohet me anë të metodës së vlerësimit të nxënësve me “*detyra pune*”. Provimi praktik do të kryhet në repartin e shkollës për punime mekanike, ose në aktivitete private për punime mekanike.
- Koha për realizimin e të gjitha detyrave duhet të jetë jo më shumë se **3 orë**, në përputhje kjo me Udhëzimin për organizimin dhe zhvillimin e provimeve në AFP.
- Në vlerësimin e kompetencave profesionale, rekomandohet t’i lihet hapësirë për vlerësime edhe bashkëbisedimit profesional ndërmjet komisionit dhe nxënësit, pasi ai është element i rëndësishëm i secilës prej kompetencave të listuara.
- Është *e domosdoshme dhe shumë e rëndësishme* që për çdo detyrë, qysh në fillim të provimit të praktikës profesionale, nga mësuesit/instruktorët (organizatorët e provimit) t’i kushtohet vëmendje “*përcaktimit dhe zbatimit të rregullave të teknikës së sigurimit dhe të ruajtjes së mjedisit*” gjatë gjithë kryerjes së detyrave për çdo nxënësi.
- Për çdo detyrë, komisioni i vlerësimit duhet të përgatisë instrumentet përkatëse të vlerësimit sipas kompetencave profesionale. Instrumenti i vlerësimit për secilën detyrë duhet të përfshijë të gjitha hapat e realizimit të saj, duke filluar nga përgatitja e vendit, mjeteve dhe veglave të punës etj.
- Gjithashtu për çdo detyrë komisioni duhet të përfshijë në vlerësim një element shumë të rëndësishëm, i cili është sistemimi dhe pastrimi i vendit dhe i mjeteve të punës pasi nxënësi ka realizuar dhe përfunduar detyrën.

- Për realizimin e detyrave, nxënësve duhet t'u sigurohen pajisjet, materialet dhe veglat për realizimin e kësaj detyre.
- Instrumenti i vlerësimit duhet të përfshijë në përmbajtjen e tij edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale si vetëkontrolli, përgjegjshmëria, manifestimi i guximit, angazhimi fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme si dhe komunikimi, bashkëpunimi në grup, bashkëveprimi ndërmjet njëri tjetrit etj.
- Gjithashtu, komisioni duhet të hartojë dhe një listë kriteresh vlerësimi për produktin përfundimtar.
- Komisioni i provimit për të gjitha detyrat parapërgatit tezat e provimit ku nxënësi/grupi në mënyrë të rastësishme zgjedh njërën prej tyre. Komisioni i provimit duhet të përgatisë paraprakisht instrumentin e vlerësimit me procedurat/hapat/etapat e kryerjes së detyrave. Komisioni nuk duhet të ndërhyjë gjatë zhvillimit të provimit.
- Vlerësimi i të gjitha detyrave bëhet me listë kontrolli në bazë të instrumenteve përkatëse të vlerësimit.

Udhëzime për realizimin e Detyrës 1: “Përdorimi i traktorin me rrota”.

Kjo detyrë do të realizohet në fermën e shkollës, sheshe dhe rrugë për ecje me traktorin me rrota.

Komisioni i provimit paraprakisht ka përgatitur tezat të cilat përmbajnë procese pune që lidhen me përdorimin e traktorit me rrota.

Nxënësit në mënyrë individuale realizojnë etapat e proceseve të punës që lidhen me përdorimin e traktorit me rrota: kryen ecje në fushë me traktor me rrota, manovron me agregatin traktor me rrota, kryen punime të mirëmbajtjes dhe të riparimeve të thjeshta në traktorin me rrota, pastron vendin, mjetet dhe pajisjet e përdorura sipas procesit, zbatimin e kërkesave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit si dhe duke zbatuar rregullat e komunikimit me etikë profesionale.

Për realizimin e detyrës, nxënësve duhet t'u sigurohen:

- Traktor me rrota
- Vegla dhe pajisje të mirëmbajtjes së traktorit me rrota.
- Vegla dhe pajisje të riparimeve të thjeshta të traktorit me rrota.
- Informacione të shkruara ose elektronike të siguruar nga burime të ndryshme mbi procedurat e përdorimit, mirëmbajtjes dhe riparimeve të lehta të traktorit me rrota.
- Dokumentacion teknik.
- Kompjuter dhe lidhje interneti.
- Udhëzues, skema, katalogë, rregullore etj.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës. Realizimi i pranueshëm i detyrës do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit. Gjatë bashkëbisedimit profesional, komisioni drejton pyetjet veçanërisht në pikat kritike.

Udhëzime për realizimin e Detyrës 2: “Përdorimi i makinave për punimin e tokës”.

Kjo detyrë do të realizohet në fermën e shkollës ose ferma bujqësore të rajonit.

Komisioni i provimit paraprakisht ka përgatitur tezat të cilat përmbajnë procese pune që lidhen me përdorimin e makinave për punimin e tokës.

Nxënësit në mënyrë individuale realizojnë etapat e proceseve të punës që lidhen me punimin e tokës duke përdorur: plugjet për punimin e tokës, disqet për punimin e tokës, frezat për punimin e tokës, makina të tjera për punime plotësuese të tokës, kryen punime të mirëmbajtjes dhe të riparimeve të thjeshta në makinat bujqësore për punimin e tokës, të pastrojë vendin, mjetet dhe pajisjet e përdorura sipas procesit, zbatimin e kërkesave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit si dhe duke zbatuar rregullat e komunikimit me etikë profesionale.

Për realizimin e detyrave, nxënësve duhet t’u sigurohen:

- Mjete motorike.
- Makina bujqësore: plugje, disqe dhe freza.
- Makina të tjera bujqësore si: lesa, kultivatorë, brana etj.
- Informacione të shkruara ose elektronike të siguruara nga burime të ndryshme mbi procedurat e përdorimit, mirëmbajtjes dhe riparimeve të lehta të traktorit me rrota.
- Dokumentacion teknik dhe financiar.
- Kompjuter dhe lidhje interneti.
- Udhëzues, skema, katalogë, rregullore etj.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës. Realizimi i pranueshëm i detyrës do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit. Gjatë bashkëbisedimit profesional, komisioni drejton pyetjet veçanërisht në pikat kritike.

Udhëzime për realizimin e Detyrës 3: “Përdorimi i makinave mbjellëse”.

Kjo detyrë do të realizohet në fermën e shkollës ose ferma bujqësore të rajonit.

Komisioni i provimit paraprakisht ka përgatitur tezat të cilat përmbajnë procese pune që lidhen me përdorimin e makinave mbjellëse.

Nxënësit në mënyrë individuale realizojnë etapat e proceseve të punës që lidhen me përdorimin e makinave mbjellëse: me rreshta, makinat mbjellëse me saktësi, makinat mbjellëse të patates, makinat mbjellëse të fidanëve, kryen punime të mirëmbajtjes dhe riparime të thjeshta në makinat mbjellëse, të pastrojë vendin, mjetet dhe pajisjet e përdorura sipas procesit, zbatimin e kërkesave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit si dhe duke zbatuar rregullat e komunikimit me etikë profesionale.

Për realizimin e detyrës, nxënësve duhet t’u sigurohen:

- Mjete motorike bujqësore.
- Makina mbjellëse me rreshta.
- Makina mbjellëse me saktësi.
- Makina mbjellëse të patates.
- Makina mbjellëse të fidanëve.
- Vegla dhe pajisje të thjeshta për mirëmbajtjen dhe riparimin e makinave mbjellëse.
- Mjete kancelarie
- Informacione të shkruara ose elektronike të siguruar nga burime të ndryshme mbi procedurat e përdorimit, mirëmbajtjes dhe riparimeve të lehta të makinave mbjellëse.
- Dokumentacion teknik dhe financiar.
- Kompjuter dhe lidhje interneti.
- Udhëzues, skema, katalogë, rregullore etj.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës. Realizimi i pranueshëm i detyrës do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit. Gjatë bashkëbisedimit profesional, komisioni drejton pyetjet veçanërisht në pikat kritike.

Udhëzime për realizimin e Detyrës 4: “Përdorimi i makinave dhe pajisjeve për shërbimin e bimëve”.

Kjo detyrë do të realizohet në fermën e shkollës ose ferma bujqësore të rajonit.

Komisioni i provimit paraprakisht ka përgatitur tezat të cilat përmbajnë procese pune që lidhen me përdorimin e makinave për shërbimin e bimëve.

Nxënësit në mënyrë individuale realizojnë etapat e proceseve të punës që lidhen me përdorimin e lesave, kultivatorëve, aparatet spërkatëse të shpinës për trajtimin e bimëve, makinat spërkatëse për trajtimin e bimëve, makinat pluhurorese për trajtimin e bimëve, makinat për shpërndarjen e plehut organik të ngurtë, makinat për shpërndarjen e plehut kimik të ngurtë, kryen punime të mirëmbajtjes dhe riparimeve të thjeshta në makinat për shërbimin e bimëve, të pastrojë vendin, mjetet dhe pajisjet e përdorura sipas procesit, zbatimin e kërkesave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit si dhe duke zbatuar rregullat e komunikimit me etikë profesionale.

Për realizimin e detyrës, nxënësve duhet t’u sigurohen:

- Mjete motorike bujqësore.
- Aparatet spërkatëse të shpinës.
- Makina për spërkatjen dhe pluhurosjen e bimëve.
- Makina për shpërndarjen e plehrave organike të ngurta.
- Makina për shpërndarjen e plehrave kimike të ngurta.
- Vegla dhe pajisje të thjeshta për mirëmbajtjen dhe riparimin e makinave për shërbimin e bimëve.
- Mjete kancelarie

- Informacione të shkruara ose elektronike të siguruar nga burime të ndryshme mbi procedurat e përdorimit, mirëmbajtjes dhe riparimeve të lehta të makinave për shërbimin e bimëve.
- Dokumentacion teknik dhe financiar.
- Kompjuter dhe lidhje interneti.
- Udhëzues, skema, katalogë, rregullore etj.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës. Realizimi i pranueshëm i detyrës do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit. Gjatë bashkëbisedimit profesional, komisioni drejton pyetjet veçanërisht në pikat kritike.

Udhëzime për realizimin e Detyrës 5: “Përdorimi i makina dhe pajisje për korrjen/vjeljen dhe mbledhjen e prodhimit”.

Kjo detyrë do të realizohet në fermën e shkollës ose ferma bujqësore të rajonit.

Komisioni i provimit paraprakisht ka përgatitur tezat të cilat përmbajnë procese pune që lidhen me përdorimin e makinat për mbledhjen e prodhimit.

Nxënësit në mënyrë individuale realizojnë etapat e proceseve të punës që lidhen me përdorimin, makinave për kositjen e foragjereve, makinave për tharjen dhe mbledhjen e foragjereve, autokombajnat për vjeljen e grurit dhe misrit, makinat vjelëse të drufrutorëve, makinat vjelëse të frutrrënjorëve, të pastrojë vendin, mjetet dhe pajisjet e përdorura sipas procesit, zbatimin e kërkesave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit si dhe duke zbatuar rregullat e komunikimit me etikë profesionale.

Për realizimin e detyrës, nxënësve duhet t’u sigurohen:

- Mjete motorike bujqësore.
- Makina për kositjen e foragjereve/barit..
- Makina për tharjen dhe mbledhjen e foragjereve/barit.
- Makina për ngjeshjen dhe lidhjen e sanës.
- Autokambajnë për vjeljen e misrit, grurit.
- Makina vjelëse të drufrutorëve dhe të frutrrënjorëve.
- Vegla dhe pajisje të thjeshta për mirëmbajtjen dhe riparimin e makinave për mbledhjen e prodhimit.
- Informacione të shkruara ose elektronike të siguruar nga burime të ndryshme mbi procedurat e përdorimit, mirëmbajtjes dhe riparimeve të lehta të makinave për mbledhjen e prodhimit.
- Dokumentacion teknik dhe financiar.
- Kompjuter dhe lidhje interneti.
- Udhëzues, skema, katalogë, rregullore etj.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës. Realizimi i pranueshëm i detyrës do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit. Gjatë bashkëbisedimit profesional, komisioni drejton pyetjet veçanërisht në pikat kritike.

Udhëzime për realizimin e Detyrës 6: “Përdorimi i makinave për përpunimin, magazinimin dhe ruajtjen e prodhimit”.

Kjo detyrë do të realizohet në fermën e shkollës ose ferma bujqësore të rajonit. Komisioni i provimit paraprakisht ka përgatitur tezat të cilat përmbajnë procese pune që lidhen me përdorimin e makinave për përpunimin e prodhimit magazinimin dhe ruajtjen e prodhimit.

Nxënësit në mënyrë individuale realizojnë etapat e proceseve të punës që lidhen me

proceset të punës duke përdorur, makinat për tharjen e prodhimit, trioret për pastrimin e prodhimit, mullinjtë e bluarjes për blegtorinë, makinat grirëse të silazhit makina të tjera të përpunimit të prodhimit, kryen veprime të magazinimit dhe ruajtjes së prodhimit kryen mirëmbajtjen dhe riparimin e makinave për përpunimin magazinimin dhe ruajtjen e prodhimit, të pastrojë vendin, mjetet dhe pajisjet e përdorura sipas procesit, zbatimin e kërkesave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit si dhe duke zbatuar rregullat e komunikimit me etikë profesionale.

Për realizimin e detyrës, nxënësve duhet t’u sigurohen:

- Mjete motorike bujqësore.
- Makina të përpunimit të prodhimit.
- Vegla dhe pajisje të thjeshta për mirëmbajtjen dhe riparimin e makinave për përpunimin e prodhimit e prodhimit.
- Informacione të shkruara ose elektronike të siguruar nga burime të ndryshme mbi procedurat e përdorimit, mirëmbajtjes dhe riparimeve të lehta të makinave për përpunimin e prodhimit.
- Dokumentacion teknik dhe financiar.
- Kompjuter dhe lidhje interneti.
- Udhëzues, skema, katalogë, rregullore etj.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës. Realizimi i pranueshëm i detyrës do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit. Gjatë bashkëbisedimit profesional, komisioni drejton pyetjet veçanërisht në pikat kritike.

Udhëzime për realizimin e Detyrës 7: “Shitblerja e mjeteve, pajisjeve dhe makinerive bujqësore”.

Kjo detyrë do të realizohet në mjediset e klasave mësimore ose në bizneset përkatëse.

Komisioni i provimit paraprkishtë ka përgatitur tezat të cilat përmbajnë procese pune që lidhen me shitblerjen e mjeteve, pajisjeve dhe makinerive bujqësore.

Nxënësit në mënyrë individuale realizojnë etapat e proceseve të punës që lidhen me

shitblerjen e mjeteve, pajisjeve dhe makinerive bujqësore si dhe për të vendosur marrëdhënie me furnitorët, blerjet dhe plotësimi i dokumentacionin përkatës, vendos marrëdhënie me klientët, kryen shitjen e mjeteve, pajisjeve dhe makinerive bujqësore dhe plotëson dokumentacionin përkatës, kryen blerje dhe shitje në Web-shop, të pastrojë vendin, mjetet dhe pajisjet e përdorura sipas procesit, zbatimin e kërkesave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit si dhe duke zbatuar rregullat e komunikimit me etikë profesionale.

Për realizimin e detyrës, nxënësve duhet t’u sigurohen:

- Mjedisi i zyrave mësimore.
- Materiale kancelerie dhe kompjuter në lidhje me internetin.
- Dokumente të ndryshme model nga fermat reale dhe të përgatitura nga mësuesi.
- Dëftesa lëvrimi, formularë, fatura, regjistra të blerjeve dhe shitjeve të marra nga praktika ose përpunuar në modulet e mëparshme.
- Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
- Përmbledhje e legjislacionit në fushën e teknologjisë bujqësore (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
- Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
- Dokumentacion teknik dhe financiar.
- Udhëzues, skema, katalogë, rregullore etj.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kriteret për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës. Realizimi i pranueshëm i detyrës do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit. Gjatë bashkëbisedimit profesional, komisioni drejton pyetjet veçanërisht në pikat kritike.

Udhëzime për realizimin e Detyrës 8: “Përdorimi i makinave blegtorale”.

Kjo detyrë do të realizohet në fermën e shkollës ose ferma bujqësore të rajonit. Komisioni i provimit paraprkishtë ka përgatitur tezat të cilat përmbajnë procese pune që lidhen me përdorimin e makinave blegtorale.

Nxënësit në mënyrë individuale realizojnë etapat e proceseve të punës që lidhen me

përdorimin dhe mirëmbajtjen e makinave, përdor dhe mirëmban makinat mjelëse portative, përdor dhe mirëmban pajisjet për qethjen e bagëtive, përdor dhe mirëmban impiantet e

mekanizuar në komplekset blegtorale, të pastrojë vendin, mjetet dhe pajisjet e përdorura sipas procesit, zbatimin e kërkesave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit si dhe duke zbatuar rregullat e komunikimit me etikë profesionale.

Për realizimin e detyrës, nxënësve duhet t'u sigurohen:

- Makina dhe pajisje blegtorale (makina mjelëse, pajisje qethëse- burime energjie, mjete motorike).
- Informacione të shkruara ose elektronike të siguruar nga burime të ndryshme mbi procedurat e përdorimit, mirëmbajtjes dhe riparimeve të lehta të makinave mbjellëse.
- Dokumentacion teknik për makinat dhe pajisjet e blegtorisë.
- Kompjuter dhe lidhje interneti.
- Udhëzues, skema, katalogë, manuale, rregullore etj.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës. Realizimi i pranueshëm i detyrës do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit. Gjatë bashkëbisedimit profesional, komisioni drejton pyetjet veçanërisht në pikat kritike.

Secili nga postet e punës së lartpërmendur të ketë listë vlerësimi më vete dhe në fund të realizimit të detyrave të parashikuara, të bëhet tabela përmbledhëse e pikëve dhe të hidhet nota përkatëse.